

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë
Факултет за бизнис и економија
Faculty of Business and Economics

STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA:

NDIKIMI I BENCHMARKING-UT NË PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE NË INSTITUCIONET PRIVATE TË
ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

Kandidati:

Kreshnik Dreshaj

Mentori:

Prof. Dr. Izet Zeqiri

Tetovë, 2020

FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE

Dëshiroj të faleminderoj të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre në përpilimin dhe realizimin e këtijë projekti hulumtues.

Realizimi i këtijë punimi nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e jashtëzakonshme të mbikëqyrësit dhe njëkohësisht mentorin tim Prof. Dr. Izet Zeqirin. Entuziazmi, njohuria dhe vëmendja e tij e detajuar kanë qenë një frymëzim dhe mbështetje e vazhdueshme e studimeve dhe hulumtimeve. Përveç mentorit tim, do të doja të falënderoj pjesën tjetër të komisionit tim të tezës si Asoc. Dr. Gadaf Rexhepi dhe Asoc. Dr. Sadri Alija për të gjitha udhëzimet e tyre, idetë entuziazmin dhe inkurajimin e vazhdueshëm.

Gjithashtu, faleminderoj të gjithë miqtë dhe të afërmit e mi për ndihmë në gjetjen e dokumenteve, raporteve, dhe fotografive të përmendura në këtë tezë.

Së fundi, dëshiroj të falënderoj familjen time. Përkushtimi juaj, dashuria dhe mbështetja e pakushtëzuar, sensi i humorit, durimi, optimizmi dhe këshilla ishin pjesa më e vlefshme e gjithë këtij projekti.

Abstrakt

Rritja e vazhdueshme e konkurrencës, kërkesat e mëdha studentore si dhe vëllimi i informacionit të disponueshëm janë vetëm disa faktorë të cilët po luajnë një role të veçantë në aplikimin e metodave të ndryshme në institucionet arsimore. Në mënyrë që institucionet e larta arsimore të aplikojnë ndryshime thelbësore dhe të qëndrueshme në ofrimin e produktivitetit dhe efikasitetit, një mënyrë e re e të menduarit që ndërton efikasitetin dhe një dëshirë për mësim të vazhdueshëm duhet të jetë e integruar në strukturat institucionale. Ndër strategjitë dhe teknikat e përmirësimit që ka gjetur me se shumti aplikim në veprimtarinë e edukimit të lartë arsimor është padyshim metoda e “Benchmarking-ut”, metode kjo e cila theksonë rëndësinë e krahasimit në vlerësimin e cilësisë së arsimit të lartë. Kur kolegjet dhe universitetet tentojnë të analizojnë veprimtarinë e tyre në krahasim me konkurrentet e tyre, ato padyshim që përfitojnë informacione relevante të cilat ndihmojnë në përmirësimin e aktiviteteve të tyre- fokusi primar në përmirësimin e shërbimeve. Në këtë pikë krahasimi, institucionet e arsimit të lartë ndihmojnë veten e tyre në kapërcimin e rezistencës ndaj ndryshimit, sigurimin e një strukturë për vlerësimin e jashtëm dhe lehtësimin në shkëmbimin e informacionit ndërmjet konkurrenteve.

Qëllimi i këtijë projekti hulumtues është të shpjegojë pse, kur dhe si benchmarkingu i ndihmon institucionet arsimore që vazhdimisht të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të tyre duke rrespektuar standardin aktual. Përmbajtja teorike e projektit mbështetet totalisht në literature duke përfshirë hulumtime të ngjajshme dhe raporte mjaft relevante të cilat përshtaten hovshem me qëllimin e këtijë projekti. Padyshim që në përputhje me qëllimin e hulumtimit është aplikuar edhe metoda sasiore.

Ky projekt hulumtues shpjegon se si benchmarkingu iu lejon institucioneve arsimore monitorimin e performancës dhe menaxhimin me ndryshime: përkatesisht përfitimin e një perspektivë të pavarur rreth performancës arsimore në krahasim me konkurrentet. Gjithashtu hulumtimi shpalos edhe informacionet se si institucionet e arsimit të lartë në Kosovë ofrojnë shërbimet studentore të nivelit ndërkombëtar.

Fjalët kyçe: Krahasimi, Arsimi i lartë, Cilësia, Menaxhimi.

Abstract

The constant increase in competition, the huge student's demand as well as the volume of dissemination information available are just some of the factors which play a special role in the application of different methods on university' activities. In order to more effective and productive, one new thing you might think about is building efficiency and a desire for potential teaching for integrated design in the best structures . One of the best techniques applied by universities and colleges of higher education institutions is undoubtedly the "benchmarking" a method that emphasizes the importance of comparison in assessing the quality of higher education. When colleges and universities tend to analyze their performance compared to their competitors, they receive relevant information that helps them to improve their activities - the primary focus on improving university services. At this point of comparison, higher education institutions help themselves in overcoming resistance to change, providing a structure for external evaluation, and facilitating the exchange of information between competitors.

The purpose of this research project is to explain why, when and how benchmarking helps educational institutions to continually improve the quality of their services by adhering to current standards. The theoretical content of the project relies entirely on the literature, including related researches and highly relevant reports that are rapidly adapted to the purpose of the project. Undoubtedly, in accordance with the purpose of the research, the quantitative method was also applied.

This research project explains how benchmarking allows educational institutions to monitor performance and manage changes: namely gaining an independent perspective on educational performance over competitors. The research also reveals information on how higher education institutions in Kosovo provide international student services.

Keywords: Comparison, Higher Education, Quality, Management.

Përmbajtja

1.1	Lënda e hulumtimit.....	8
1.2	Qëllimi i hulumtimit	9
1.3	Problematika e ngritur	10
1.4	Hipotezat e ngritura.....	11
1.5	Metodologjia e hulumtimit	11
1.6	Struktura e punimit.....	12
2.2	Rëndësia e arsimit të lartë sot.....	15
2.2.1	Pse është kaq i rëndësishëm arsimi në jetën tonë?	15
2.2.1.1	Përfitimet nga arsimi i lartë	16
2.3	Arsimi i lartë në Kosovë.....	18
2.3.1	Rëndësia e arsimit për Kosovën.....	19
2.3.1.1	Arsimi dhe Performancat Ekonomike.....	20
2.3.2	Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë.....	21
2.3.3	Universitetet privatë në Kosovë.....	23
2.3.3.1	Funksionet primare të këtyre institucioneve private arsimore	31
2.3.3.2	Benchmarkingu në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë	31
2.3.3.3	Ofrimi i shërbimeve në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë.....	38
2.3.3.4	Ndikimi i benchmarkingut në përmisimin e shërbimeve.....	41
3.1	Qëllimi hulumtimit.....	44
3.2	Qasja hulumtuese	45
3.3	Plani Kërkimor	48
3.3.1	Pyetëtori	48
3.3.2	Përzgjedhja e Mostrës	49
3.3.3	Procedura	49
3.4	Mbledhja e të Dhënave.....	50
3.5	Vlefshmëria dhe Besueshmëria	50
3.6	Rrethanat Limituese.....	51
4.1	Analiza dhe komentimi i rezultateve	53
4.2	Rezultatet e pyetësoreve të realizuar më përfaqësuese të institucioneve private.....	62
5.1	Përfundimet teorike.....	68
5.2	Përfundimet praktike.....	69
5.3	Rekomandimet	71

Referencat.....	74
Shtojcat.....	78
Appendix#1: Pytësori.....	78
Appendix#2: Pytësori.....	81

KAPITULLI 1

HYRJE

1.1 Lënda e hulumtimit

1.2 Qëllimi i hulumtimit

1.3 Problematika e ngritur

1.4 Hipotezat e ngritura

1.5 Metodologjia e hulumtimit

1.6 Struktura e punimit

1.1 Lënda e hulumtimit

Shumë kohë më parë, të dhëna krahasuese janë përdorur në disa industri të ndryshme, përfshirë edhe arsimin e lartë në përgjigje të rritjes së konkurrencës dhe një tregu në rënie të shpejtë. Si në aspektin konceptual poashtu edhe në atë praktik, strategjia e krahasimit apo e quajtur edhe si ajo e “Benchmarkingut” përdoret për të përmirësuar proceset administrative, si dhe modelet mësimore në kolegje dhe universitete. Gjithashtu, kjo strategji shume e rëndësishme ndihmon edhe në ekzaminimin e proceseve dhe modeleve të institucioneve të larta arsimore duke përshtatur teknikat dhe qasjet e tyre. Në fushen arsimore, krahasimi është një proces sistematik për matjen dhe krahasimin e proceseve arsimore brenda një institucioni arsimorë me ato të një institucioni tjetër, duke sjellë një fokus të jashtëm në aktivitete, funksione ose operacione të brendshme. Qëllimi kryesorë i aplikimit të kësaj metode në institucionet e lartëpermendura është të sigurojë personelin kryesor përgjegjës për proceset si dhe të formoj një kriter të jashtëm për matjen e cilësisë dhe kostos së aktiviteteve të brendshme. Për më shumë, kjo metode krahasuese ndihmon të identifikoj hapësirat për përmirësim. Kjo metode duhet të jetë e integruar në operacionet themelore në të gjithë institucionin si një proces sistematik që analizon të dhënat e mbledhura. Benchmarking-u përqipet të përgjigjet në pyetjet e mëposhtme:

- Si qëndrojmë ne në krahasim më të tjerët?
- Sa të mirë duam të jemi?
- Si mund të adaptojmë ndryshimet në institucionin tonë?
- Si mund të jemi më të mirë se më të mirët?

Per ti'u përgjigjur këtyre pyetjeve, në këtë hulumtim janë përdorur katër ndarje të metodes se benchmarking-ut si:

1. Planifikimi i studimit
2. Kryerja e hulumtimit
3. Analizimi i të dhënave dhe
4. Përshtatja e gjetjeve

Hapi i parë përfshin zgjedhjen dhe përcaktimin e procesit administrativ që do të studiohet, duke identifikuar se si do të matet procesi. Hapi i dytë përfshin të dhënat e procesit të krahasimit që mbledhen duke përdorur hulumtime parësore dhe/ose sekondare në lidhje me kolegjet/universitetet që studiohen. Hapi i tretë analizon të dhënat e mbledhura për llogaritjen e gjetjeve të hulumtimit dhe hartimin e rekomandimeve. Përshtatja e gjetjeve në raport me “përmirësimin” është hapi i katërt në përsëritjen e parë të një cikli krahasimi, dhe qëllimi kryesor i projektit.

1.2 Qëllimi i hulumtimit

Si kurr më parë, përmirësimi i performancës së universitetit është bërë një ndër çështjet më të diskutueshme ndërkombëtare si rezultat i rritjes së një mjedisi më të hapur dhe konkurrues të fushës arsimore. Për ta pasur këtë situatë nën kontroll, universitetet po aplikojnë metodën e krahasimit “Benchmarking-un”, si një proces të brendshëm organizativ i cili synon të përmirësojë performancën e organizatës duke mësuar për përmirësime të mundshme të proceseve. Rritja e krahasimit në arsimin e lartë pasqyron kërkimin për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë dhe për një mënyrë më efektive të përmirësimit të performancës në një sektor të arsimit të lartë shumë të larmishëm. Benchmarking gjithashtu shërben për nevojat e institucioneve individuale për të mësuar se si të përmirësohen, të ndryshojnë dhe të menaxhojnë operacionet në një mënyrë më profesionale. Institucionet ambicioze zgjedhin krahasimin si një mjet për përmirësimin e pozitës së tyre në nivelin ndërkombëtar. Metoda e krahasimit identifikon boshllëqet në performancën arsimore dhe kërkon qasje të reja për përmirësime, monitoron përparimin, rishikon përfitimet dhe siguron adaptimin e praktikave të mira.

Andaj, qëllimi i këtijë projekti hulumtues është;

- Të shpjegojë pse, kur dhe si benchmarkingu i ndihmon institucionet arsimore që vazhdimisht të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të tyre duke rrespektuar standardin aktual.

- Të shpalos se si metoda krahasuese iu lejon institucioneve arsimore monitorimin e performancës dhe menaxhimin me ndryshime: përkatesisht përfitimin e një perspektivë të pavarur rreth performancës arsimore në krahasim me konkurrentet.
- Të sqaroj se si institucionet e arsimit të lartë në Kosovë ofrojnë shërbimet studentore të nivelit ndërkombëtarë.

1.3 Problematika e ngritur

Universitetet dhe kolegjet janë institucione arsimore në të cilat studiuesit kontribuojnë në njohuri përmes shkëmbimit të ideve me komunitetin e gjerë. Duke marrë parasyshë kërkesën e madhe studentore për të përzgjedhur universitetet më të mira më famë botërore, institucionet arsimore tentojnë të analizojnë tregun për të përmisuar dukshem aktivitetet e tyre duke tërhequr më shumë studentë tek vetja e tyre. Benchmarking-u si një metode mjaft efektive krahasuese, mundëson ndarjen e strukturuar të ideve dhe praktikave të mira mbi pikat e forta dhe të dobëta institucionale. Nëse një institucion arsimorë posedon informacionin mbi performancën aktuale institucionale dhe cilësinë e procesit të ndërkombëtarizimit, atëhere ai institucion do të posedoj mundësi ende më të mira për zhvillimin e strategjive adekuate institucionale. Në këtë mënyrë, institucioni do të mbajë nivel më të lartë të ndërgjegjësimit, dukshmërisë, profilit institucional, reputacionit dhe fitimit të një avantazhi të fortë konkurrues. Aplikimi i Benchmarking-ut në mënyrën e duhur do të ju ndihmojë institucioneve arsimore të;

- Vetëvlerësoni institucionin tuaj
- Kuptoni proceset e formulimit dhe zbatimit të strategjisë
- Fitoni informacione dhe të dhëna në lidhje me veten dhe institucionet e tjera për të mbështetur vendimmarrjen
- Identifikoni fushat për përmirësim
- Vendosni objektiva për zhvillimet institucionale

Duke marrë parasysh këtë rrjedhë, në këtë punim rëndësi fillestare do ti jepet peshës së madhe të Benchmarkingut si dhe shërbimeve universitare në nivel ndërkombëtarë.

1.4 Hipotezat e ngritura

Projekti hulumtues do t'ju jap përgjigje këtyre pyetjeve kërkimore;

Pyetja kërkimore 1: Si ndikon benchmarkingu në marrjen e vendimeve menagjieriale në aktivitetet universitare?

Pyetja kërkimore 2: Cilat janë pikat e dobëta dhe të forta të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë?

Pyetja kërkimore 3: Çfarë lloj përmirësimesh të shërbimeve duhet të zbatohen në aktivitetet arsimore?

Pyetja kërkimore 4: Sa janë të kënaqur studentët më shërbimet universitare që ju ofrohen atyre?

Ndërkaq, si hipoteza që ky punim do të t'i testoj do të jenë:

H1: Benchmarking ndihmon institucionet arsimore që vazhdimisht të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të tyre: institucionet respektojnë standardin aktual, dhe pastaj përpiqen ta tejkalojnë atë

H2: Benchmarking-u iu siguron institucioneve arsimore të dhënat me të vlefshme për teknologjinë e fundit dhe proceset e ndjekura në mjedisin e tyre

H3: Benchmarkingu i lejon institucioneve arsimore monitorimin e performancës dhe menaxhimin me ndryshime: përkatesisht përfitimi i një perspektivë të pavarur rreth performancës arsimore në krahasim me konkurrentet

H4: Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë ofrojnë shërbime studentore të nivelit ndërkombëtare

Hipotezat e ngritura me lartë do të vërtetohen sipas rezultateve të nxjerra të cilat do të kalkuloohen në formë mekanike nga ana e studiuesit.

1.5 Metodologjia e hulumtimit

Pjesa e metodologjise së hulumtimit paraqet arkitekturën e grumbullimit të të dhënave të nevojshme për projektin. Më fjalë të tjera, ky seksion përfshinë të gjitha veprimet që duhen

ndërmarrë për të hetuar problemin e hulumtimit. Këto veprime përbëhen prej procedurave ose teknikave specifike të identifikimit, përzgjedhjes, përpunimit dhe analizimit të informacionit të përdorur për problemin. Po në këtë rrjedhë është edhe me i lehtë ndërtimi i vlefshmërisë dhe besueshmërisë së përgjithshme të studimit. Nëse metodologjia e punimit realizohet në mënyrën e duhur, atëherë projekti do të jetë i gatshëm për të ju përgjigjur dy pyetjeve pasuese: si u mblodhën të dhënat dhe si u analizuan ato? Në mënyrë që projekti të kompletohet në mënyrë të qartë dhe të suksesshme, hulumtimi do të përfshijë të dy llojet e të dhënave: të dhënat sekondare dhe të dhënat primare. Të dhënat sekondare do të mbledhen nga regjistrimet, informacionet e mbledhura nga departamentet qeveritare, të dhënat organizative dhe të dhënat që fillimisht u mblodhën për qëllime të tjera kërkimore. Pas kompletimit të të dhënave sekondare, atëherë do të aplikohen të dhënat primare. Si bazë për përgaditjen e këtij punimi do të shërbejnë anketat e realizuara të cilat do të sigurojnë të dhënat e nevojshme.

1.6 Struktura e punimit

Punimi është i ndarë në gjashtë kapitujt e paraqitur si më poshtë:

KAPITULLI I. HYRJE

1. Parathënie
2. Lënda e hulumtimit
3. Rëndësia e hulumtimit
4. Pyetje kërkimore dhe hipotezat e parashtruara
5. Metodologjia e studimit
6. Qëllimet e studimit

KAPITULLI II. RISHIKIMIM I LITERATURES

1. Rëndësia e arsimit të lartë sot
2. Pse është kaq i rëndësishëm arsimi në jetën tonë?
3. Përfitimet nga arsimi i lartë
4. Arsimi i lartë në Kosovë

5. Rëndësia e arsimit për Kosovën
6. Arsimi dhe Performancat Ekonomike
7. Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë
8. Universitetet privatë në Kosovë
9. Funkcionet primare të këtyre institucioneve private arsimore
10. Benchmarkingu në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë
11. Metodologjia e krahasimit e aplikuar nga institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë
12. Ofrimi i shërbimeve në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë

KAPITULLI III. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

1. Qellimi i hulumtimit
2. Llojet e hulumtimit
3. Procesi i hulumtimit
4. Mostra e hulumtimit
5. Instrumenti i hulumtimit
6. Limitimet e hulumtimit

KAPITULLI IV. PREZANTIMI DHE ANALIZA E TE DHENAVE

1. Prezantimi Deskriptiv dhe Statistikor
2. Kryqëzimi i Tabelave
3. Analiza e te Dhenave
4. Testimi i Hipotezave

KAPITULLI V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Përfundime
2. Rekomandime

KAPITULLI VI. REFERENCAT

- Referencat

KAPITULLI 2

RISHIKIMIM I LITERATURES

2.1 Rëndësia e arsimit të lartë sot

2.1.1 Pse është kaq i rëndësishëm arsimi në jetën tonë?

2.1.1.1 Përfitimet nga arsimi i lartë

2.2 Arsimi i lartë në Kosovë

2.2.1 Rëndësia e arsimit për Kosovën

2.2.1.1 Arsimi dhe Performancat Ekonomike

2.1.1 Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë

2.1.2 Universitetet privatë në Kosovë

2.1.2.1 Funksionet primare të këtyre institucioneve private arsimore

2.1.2.2 Benchmarkingu në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë

2.1.2.2.1 Metodologjia e krahasimit e aplikuar nga institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë

2.1.2.3 Ofrimi i shërbimeve në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë

2.2 Rëndësia e arsimit të lartë sot

Ndyshimet e suksesshme në arsim janë një ndër temat më të diskutueshme globale. Diskutime dhe eksperimente të ndryshme dëshirojnë të zbulojnë dhe njëkohësisht të sqarojnë sesi universitete dhe kolegje të ndryshme po luajnë role të ndryshme efektive dhe të rëndësishme në inovacionin dhe zhvillimin ekonomik (Harrison, 2017). Sipas Edmond Hoxhës (2008), në kohët e më hershme, universitetet janë konsideruar vetëm në një terminologji mjaft të ngushtë si:

- Komunitete kushtuar mësimin dhe zhvillimit personal
- Burim i ekspertizës dhe identitetit profesional
- Institucione arsimore të krijimit, testimit, vlerësimit dhe zbatimit të njohurive të reja
- Kontribues të rëndësishëm për shoqërinë dhe kombet (Standartet arsimore në bashkimin Europian dhe në Shqipëri, 2008)

Ndërsa sipas Luljeta Krasniqi- Veseli (2019), tani roli i institucioneve të arsimit të lartë është definuar edhe më gjerë dhe përfshinë pikat e indentifikuara si më poshtë:

- Universitetet cilësohen si depo gjeneruese të njohurive
- Universitetet dhe kolegjet kanë për qëllim për të pajisur të diplomuarit me njohuritë e duhura në mënyrë që ata të mund të marrin një punë të qëndrueshme
- Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë kritikë në fushat e politikës publike dhe jetës sociale & ekonomike
- Prania e universiteteve si organe të mëdha ushtron ndikim të pa mase në shoqërinë civile dhe në shtet
- Institucionet arsimore krijojnë komunitete kohezive dhe tolerante (Radio Evropa e Lirë, 2019)

2.2.1 Pse është kaq i rëndësishëm arsimi në jetën tonë?

Në përgjithësi edukimi është një ndër vlerat kryesore që ndikon drejtëpërdrejtë në cilësinë e përgjithshme të një individi, si në aspektin e shoqërisë po ashtu edhe në atë të punësimit. Me fjalë të tjera, është një nevojë mjaft thelbësore që ndimon për të jetuar një jetë të modernizuar.

Arsimi kontribuon në aftësin për të lexuar dhe shkruar, zhvillimin e një komunikimi më të mirë, përdorimin e teknologjisë, përhapjen e njohurive, etj. Për shkak të një rëndësie të tillë, qeveritë tentojnë që investimin më të madh shtetëror ta bëjnë në arsim. Kështu ata inkurajojnë njerëzit të studiojnë duke siguruar universitete të nivelit ndërkombëtar, bursa, akomodim dhe shtesa të tjera (Chitra, 2019).

Në përgjithësi, përfitimet praktike të arsimit të lartë në shekullin XXI përfshijnë:

- Fushën e ekonomisë
- Fushën e shëndetit
- Përfshirjen qytetare
- Zhvillimin personal
- Realizimin e pasioneve
- Ndjesin më të madhe të disiplinës
- Ndjenjen e arritjes

Siç mund të kuptohet nga pikat e lartë-cekura, përfitimet e arsimit të lartë nuk janë të orientuara vetëm nga karriera. Të jesh në gjendje të zhvillosh vetvetën është e paçmueshme, dhe të kesh një arsim të lartë ju ndihmon të realizoni më lehtë ëndrrat dhe planet e juaja.

2.2.1.1 Përfitimet nga arsimi i lartë

Sipas Lisa Barlow (2017), për një shoqëri moderne, arsimi është shumë i rëndësishëm. Roli i arsimit ka për qëllim zhvillimin e diçkaje të re, jo vetëm mbështetjen e risive aktuale dhe zgjerimin e tyre. Disa përfitime të identifikuara nga arsimi i lartë janë:

- **Krijimi i më shumë mundësive me arsim të lartë**

Arsimi në nivelin universitar jo vetëm që ju trajnon në fushën tuaj të zgjedhur, por gjithashtu ju ndihmon të mendoni në mënyrë analitike, të kuptoni lëndët që janë komplekse dhe t'i komunikoni ato në mënyrë efektive. Gjithashtu, arsimi krijon aftësi të rëndësishme si vet-disiplinën dhe organizimin. Në këtë mënyrë, ju gradualisht shndërroheni në një person më profesional me shumë aftësi që lidhen me punën. Duke

mësuar më shumë sesa fushës suaj të përzgjedhur, ju do ti krijoni vetëvetes tuaj me shumë mundësi të reja që mund të mos ishin të disponueshme më herët. Një fakt tjetër i vërtetë është se në ekonominë tonë sot, për individët të cilët nuk kanë një nivel mesatar arsimor, opsionet për zhvillim në karrierë ju bien automatikisht. Prandaj arsimi ju ndihmon të fitoni njohuri dhe aftësi në një gamë më të gjerë që mund t'ju kualifikojnë në pozita të kënaqshme gjatë karrierës tuaj (Rëndësia e arsimit në jetën personale, 2017).

➤ **Bëhuni dhe qëndroni konkurrues me arsimin e lartë**

Arsimi i lartë është një ndër elementet kryesore që ju krijon avantazh konkurrues në tregun e karrierës. Siç edhe e dimë se në kohërat ekonomike në të cilat jetojmë sot, gjetja e vendeve të punës nuk është e garantuar. Numri i njerëzve të papunë është relativisht shumë i lartë, dhe numri i mundësive të reja të karrierës nuk është pothuajse i mjaftueshëm për t'u ofruar njerëzve punë. Si punë-kërkues, ju jeni duke garuar me një numër të lartë të punëtorëve me përvojë që kanë qenë jashtë forcës së punës për një kohë dhe gjithashtu kërkojnë punë. Kështu, kur ju posedoni nivel të lartë arsimorë, punëdhënësit ju vlerësojnë ende më shumë në këtë aspekt, gjë që ju krijon ende me shumë mundësi për të zënë një vend pune dhe të startoni më zhvillimin dhe avancimin e karrierës suaj.

➤ **Mësoni aftësi të reja me një arsim të lartë**

Gjatë përvojës suaj si student ju mësoni dhe zhvilloni aftësi të reja. Kjo ju inkurajon të:

- Mendoni
- Analizoni
- Eksploroni ide të reja
- Bëni pyetje
- Të bëheni krijues

Këto ju lejojnë të rriteni dhe zhvilloheni edhe më tej, gjë që ju ofron më shumë përparësi konkurruese në tregun e punës.

➤ **Investoni në të ardhmen tuaj me arsim të lartë**

Investimi në arsimin tuaj do t'ju ndihmojë të arrini qëllimet tuaja të karrierës dhe të keni sukses në jetën tuaj në përgjithësi. Perfundimisht ju jeni duke e përgatitur veten për një karrierë shpërblyese dhe sfiduese që ju çon në siguri financiare dhe në një jetë më të frytshme.

➤ **Fitoni kënaqësinë e punës me arsimin e lartë**

Meqenëse një arsim i lartë ju siguron më shumë liri në ndjekjen e një karriere që ju frymëzon dhe ju intereson, ju do të shijoni më shumë karrierën tuaj. Gjërat si përfitimet e punësimit, të ardhurat më të larta dhe mundësitë e avancimit zakonisht çojnë në kënaqësi më të lartë në punë. Kur ju shpërbleheni për mundin tuaj, padyshim që kjo do të ju motivojë për të kryer punën tuaj ende më mirë. Më fjalë të tjera, kur jeni më të kënaqur me karrierën tuaj, ka më shumë të ngjarë të jeni produktiv dhe të bëheni me aktiv në kompaninë për të cilën punoni.

➤ **Arritja e një jetë më të lumtur dhe më të shëndetshme me arsim të lartë**

Arsimi i lartë ju bën më të vetëdijshëm për të kuptuar aftësit tuaja. Kjo ju mundëson të përmirësoni jetën tuaj, si dhe të kontribuoni pozitivisht në shoqëri. Kur kaloni një, dy, katër, ose gjashtë vjet duke mësuar dhe zhvilluar veten tuaj, ju do të ndjeheni më të kënaqur dhe më të lumtur ndërsa udhëheqni një jetë të arsimuar (The Importance of Higher Education in the 21st Century, 2018).

2.3 Arsimi i lartë në Kosovë

Në Kosovë arsimi i lartë (privat dhe publik), konsiderohet si faktori kyq që nxit zhvillimin demokratik dhe ekonomik të shtetit. Një tipar mbresëlënës se fundi ka qenë zgjerimi i madh në arsimin universitar. Termi "universitet" se pari u krijua nga Universiteti i Bolonjës, për herë të parë i themeluar qysh në vitin 1088, i cili edhe sot vie në konsiderate si i pari i universiteteve mesjetare (Anna dhe John Van, 2018). Universiteti i Bolonjës ishte një komunitet me autonomi administrative, grada të njohura publikisht, kurse studimi dhe objektiva të kërkimit (De Ridder-

Symoens dhe Rüegg, 1992). Që nga ajo kohe, jo vetëm në vendet me të zhvilluara botërore, por edhe në Kosovë universitetet janë përhapur pothuajse në të njëjtën formë. Faktoret kyq të cilët ndikojnë në gjenerimin e vendeve të punës si dhe në krijimin e mirëqenies së një shteti dhe shoqërie janë aftësi profesionale dhe dituria e fituar përmes arsimit të lartë. Duke marrë parasysh që Kosova është një vend shumë i ri demokratik, por jo edhe shumë i fortë në aspektin ekonomik si pasojë e luftës së fundit - që la pas shumë pasoja negative- prapë se prapë ky vend qëndron shumë mirë me investimet e bëra në sistemin arsimorë. Arsyeja e investimit në këtë sektor është pasi që arsimit të lartë cilësohet si një ndër faktoret thelbësore të transformimeve sociale dhe politike që ndikon hovshëm në zhvillimin e institucioneve të qëndrueshme shtetërore si dhe krijim e parakushteve për zhvillim ekonomik.

2.3.1 Rëndësia e arsimit për Kosovën

Kosova si një shtet mjaft i ri në krahasim me shtetet fqinje ka nevojë për të kultivuar njohuri të reja të cilat do të sjellin vetëm përfitime pozitive si në aspektin shoqërorë, poashtu edhe në atë shtetërorë. Rëndësia e arsimit për Kosovën qëndron në dy faktorët e mëposhtëm:

- a) Produktiviteti më i madh i punës dhe
- b) Shfrytëzim më i shpejt i risive teknologjike

Duke filluar me faktorin e parë, siç edhe tashmë e dimë, sa më shumë që investohet në shkollim, aq më shumë gjenerohen përfitime më të larta për individët në formën e të ardhurave. Më fjalë të tjera, për popullësinë Kosovare, pasuria me e madhe e vendit cilësohet të jetë kapitali njerëzor. Gjithashtu, shfrytëzimi i saktë i risive teknologjike shpejton procesin e kryerjes së obligimeve si në kategorinë individuale, poashtu edhe në atë shoqërore.

Sipas Hoti dhe Adnett (2004) “edhe në Kosovë, në nivelin individual, niveli i shkollimit është një faktorë vendimtarë në rritjen e probabilitetit për të gjetur dhe mbajtur punën si dhe siguron nivel më të lartë të të ardhurave në Kosovë” (fq. 14, 2004). Nga kjo ata nënkuptojnë se janë nivelet e larta arsimore të cilat rezultojnë në stimulime dhe inovacione më të mëdha, vendpunësim me të lehtë si dhe në mënyrë thelbësore përshpëtojnë procesin e transferimit të njohurive. Kjo është edhe një arsye më shumë përse shpenzimet e bëra në arsime duhet të konsiderohen si investim.

Edhe Qeveria e Kosovës është duke rishikuar që të rritë ende më shumë shpenzimet publike si dhe ato private në qdo sektor arsimor.

2.3.1.1 Arsimi dhe Performancat Ekonomike

Siç edhe është cekur më lartë, shpenzimet në arsim duhet të konsiderohen si investim pasi që arsimi i lartë cilësohet si përcaktuesi më i rëndësishem i performancës ekonomike të një vendi. Egzistojnë arsye të shumta se pse arsimi në përgjithësi ka marrë një fokus global. Së pari, egziston një lidhshmëri e drejtpërdrejtë mes arritjeve në arsim dhe performancave ekonomike. Sipas OECD-se, një vit shkolle shtesë rrit outputin afatgjatë me 6% (Reviews of National Policies for Education, 2003). Kurse De la Fuente dhe Ciccone kanë konkluduar se “një vit shkolle shtesë në popullatën në tërësi e nxit rritjen në planin afatshkurtër me 5 % dhe një rritje tjetër shtesë prej 2.5% në afat të gjatë” (Human Capital in a Global and Knowledge-based Economy, 2002). E gjithë kjo vërejtje si rezultat i asaj që niveli më i lartë i arsimit ndikon në produktivitet shumë më të lartë në punë, inovacione dhe shfrytëzim më të shpejtë të teknologjive të reja. Megjithatë, kjo ndërlidhmëri mes arsimit dhe rritjes ekonomike është prezente edhe në Kosovë.

Tabela 1. Ndërlidhmëria mes arsimit dhe rritjes ekonomike

Benefitet ekonomike dhe shoqërore për individët dhe shoqërinë nga arsimimi i lartë		
Perfitimet	Publike	Private
Ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Paga më të larta ✓ Punësim më i rregulltë ✓ Pjesëmarrje më e lartë 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Punësim më i rregulltë ✓ Pjesëmarrje më e lartë ✓ Produktivitet më i lartë ✓ Zhvillim kombëtar dhe rajonal ✓ Të ardhura tatimore më të larta dhe zvogëlimi i mbështetjes tek financat qeveritare
	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Kushte pune të përmisuara ✓ Rritje e mobilitetit personal dhe profesional 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Konsum i rritur ✓ Potencial më i lartë për transformime nga

		ekonomia e bazuar në sektore ku kërkohen aftësi të vogla në ekonomi të bazuar në dije
Sociale	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Cilësi e jetës e përmirësuar për veten dhe fëmijët ✓ Vendimmarrje më e mirë 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Ndërtimi i vendit dhe zhvillimi i lidërshiptit ✓ Pjesëmarrje demokratike; percepton më i lartë që shoqëria bazohet ne drejtësi dhe mundësi për të gjithë qytetarët
	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Status personal i përmisuar ✓ Mundësi arsmimi të rritura ✓ Stil jete më i shëndetshëm dhe jetëgjatësia e pritur më e madhe. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Mobilitet social ✓ Koherencë sociale më e madhe dhe nivele të zvogëlura të krimit ✓ Shëndet i përmirësuar ✓ Aspirata arsimore dhe ekonomike më të larta për fëmijët e tyre


Burimi: Banka Botërore 2002b: 81

2.3.2 Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë

Pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë filloi transformimi i sistemit arsimorë në vend. Ky transformim erdhi pas krizës dekadëshe që në fillim ishte nën udhëheqjen e sistemit komunist jugosllav. Kjo krizë shumëvjeqare rezultoi me pasoja shumë të mëdha në tërë ecurinë e sistemit arsimor pas luftës. Kjo dekadë e izolimit dhe diskriminimit, ka dëmtuar sistemin e arsimit në shumë aspekte, sidomos në atë financiar, akademik dhe shkencorë. Gjithashtu, ka lenë mjaft pasoja edhe në çështjet e tjera strukturore si hulumtimet shkencore, botimet, publikimet profesionale, angazhimin e stafit akademik, revista shkencore, etj. Prapë se prapë, reformat e suksesshme në sistemin e lartë arsimor në Kosovë janë me shumë sesa relevante si në aspektin politik poashtu edhe në atë social (Gjinovci, 2019).

Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë përbëhet nga institucionet publike dhe private të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyre të rregullt duke zbatuar ligjet e dhëna nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Tek këto institucione publike dhe private përfshihen institute, akademi, kolegje dhe shkolla të larta profesionale. Duhet cekur edhe faktin se institucionet e vetme që janë aktive me veprimtaritë e tyre në tregun Kosovar janë vetëm ato të cilat janë të akredituara. Siç edhe u përmend më herët, Kosova qysh kohë më parë ka aplikuar sistemin e Bolonjës, i cili sistem përmban zbatimin e sistemit të kredive, diplomën më tre cikle (niveli tre vjeçar i bachelor-it), mobilitetin e stafit dhe studentëve, kriteret e ndryshme të cilësisë dhe produktivitetit, si dhe së fundmi shtojcën e diplomës. Kushtetua e Kosovës është ajo e cila garanton se çdo individ posedon të drejtën për arsimim dhe se te gjitha institucionet e arsimit të lartë ofrojnë mundësi të barabarta për secilin individ (Instituti Gap). Institucionet publike të cilat janë të akredituara për të ushtruar lirshëm veprimtarinë e tyre në tregun Kosovar janë paraqitur më poshtë në figurën 1.

Figura 1. Numri i studentëve në universitetet publike në Kosovë 2017/18



Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2018.

2.3.3 Universitetet private në Kosovë

Arsimi i Lartë në Kosovë posedon 24 institucione private të cilat janë të gjitha të licensuara si dhe ushtrojnë lirshëm aktivitetet e tyre në tregun Kosovar. Prej këtyre 24 institucioneve, 10 prej tyre janë të licensuara si universitete, ndërsa pjesa tjetër e mbetur apo 14 prej tyre janë të licensuara si fakultete, shkolla, institute, akademi dhe kolegje. Numri i përgjithshëm i fakulteteve në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë është 89, ndërsa përbrenda këtyre fakulteteve ofrohen rreth 150 programe apo drejtime (Instituti Gap).

Tabela 2. Universitetet Private në Kosovë

Nr.	Emri i institucionit	Lloji	Vendi	Nr. i fakulteteve	Nr. i programeve
1	AAB	Universitet	Prishtinë	6	11
2	Akademia e studimeve të avancuara universitare	Akademi	Prishtinë	1	2
3	R.I.T Kosovo	Universitet	Prishtinë	1	2
4	Amerikos	Kolegj	Prishtinë	1	1
5	Biznes	Kolegj	Prishtinë	3	9
6	Dardania	Universitet	Prishtinë	7	22
7	Design Factory	Shkolle	Prishtinë	1	1
8	Ekologji	Fakultet	Shterpcë	1	1
9	Eurosport	Kolegj	Prishtinë	1	4
10	Evolucion	Institut	Prishtinë	5	9
11	Fama	Kolegj	Prishtinë	5	10
12	Gjilani	Kolegj	Gjilan	4	8
13	Iliria	Universitet	Prishtinë	3	6
14	Kolegji Univerzitar Ferizaj	Kolegj	Ferizaj	3	3
15	Kosovo Institute for Journalism and Communicaiton	Institut	Prishtinë	2	2
16	Pjeter Budi	Universitet	Prishtinë	5	11
17	Rezonanca	Universitet	Prishtinë	5	5
18	Riinvest	Universitet	Prishtinë	3	7
19	Tempulli	Kolegj	Prishtinë	2	5
20	Universiteti i Prizrenit	Kolegj	Prizren	7	7
21	Universiteti Internacional i Prishtinës	Universitet	Prishtinë	5	5

22	Universiteti për Biznes dhe Teknologji	Universitet	Prishtinë	5	5
23	Universum	Kolegj	Prishtinë	5	5
24	Victory	Kolegj	Prishtinë	3	3
25	Vizioni Evropian	Kolegj	Pejë	5	9

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2018.

Në bazë të të dhënave dhe statistikave të paraqitura në tabelen e mësipërme, mund të shohim se kemi mjaft institucione të arsimit të lartë edhe në sektorin privat. Të gjitha këto institucione posedojnë numër të ndryshëm të fakulteteve, por megjithatë, secila prej tyre ofron më shumë se një program studimorë. Këto institucione posedojnë ambient të shëndoshë dhe të sigurt duke përfshirë hapësirat e mjaftueshme në nivel ndërkombëtare, ambient të përshtatshëm të punës, bibliotekë me numër të pasur të librave të fushave të ndryshme, kabinete të pajisura me teknologjitë e fundit, laboratorë & pajisje të nevojshme për punë si dhe sigurim të cilësisë së studimeve. Tani le të hedhim një shikim dhe analizë të numri i studentëve të paraqitur në tabelen e mëposhtme:

Tabela 3. Numri i studentëve të pranuar në nivelin bachelor në vitin 2018/2019

Kolegji	Femra	Meshkuj	Gjithsej
AAB	3.851	2.724	6.575
AUK	68	53	121
Fama	375	238	613
Dukagjini	45	41	86
IBCM	42	49	91
ISPE	30	94	124
Juridika	11	63	74
QEAP Heimerer	412	151	563
Rezonanca	196	159	355
Riinvest	151	275	426
Tempulli	4	36	40
Arbëri	-	-	-
UBT	1629	1890	3519
Akademia Evolucion	130	30	160
Dardania	91	45	136
Biznesi	:	:	:
ESLG	:	:	:
Globus	:	:	:
Iliria	:	:	:
Pjetër Budi	:	:	:
Universi	:	:	:
Universum	:	:	:
Kosovo Art Academy	:	:	:
Gjithsej	7.035	5.848	12.883

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018/19

Bazuar në të dhënat e mësipërme, lehtë mund të vërehet se universiteti i parë i cili prinë me numrin më të madh të studentëve të regjistruar në nivelin Bachelor 2018/2019 është AAB me gjithsej 6,575 studentë. Në vend të dytë radhitet universiteti i UBT-së me gjithsej 3,519 studentë. Ndërsa institucionet tjera kanë të regjistruar më pak studentë, specifikisht me pak se 1000 studentë për vitin akademik 2018/19. Tani le të analizojmë numrin e përgjithshëm të studentëve në nivelin e studimeve bachelor të paraqitur në tabelen e mëposhtme:

Tabela 4. Numri i i përgjithshëm i studentëve në nivelin bachelor 2018/2019

Kolegji	Viti i studimeve												Femra	Meshkuj	Gjithsej
	I-rë		II-të		III-të		IV-të		V-të		VI-të				
	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej			
AAB	3.851	6.575	2.554	3.762	1.963	3.297	513	831	-	-	-	-	8.881	5.584	14.465
AUK	68	122	44	92	45	109	55	117	5	34	2	5	219	260	479
Fama	403	666	494	767	829	1.062	93	298	-	-	-	-	1819	974	2793
Dukagjini	45	86	23	68	6	42	3	7	-	-	-	-	77	126	203
IBM	42	91	-	-	28	66	28	42	-	-	-	-	98	101	199
ISPE	30	124	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	30	94	124
Juridika	11	74	15	53	37	116	12	18	-	-	-	-	75	186	261
QEAP Heimerer	412	564	367	521	340	465	-	-	-	-	-	-	1.119	431	1.550
Rezonanca	196	355	186	319	276	438	-	-	-	-	-	-	658	454	1.112
Rinvest	151	426	17	55	35	113	-	-	-	-	-	-	203	391	594
Tempulli	4	40	8	44	15	102	-	-	-	-	-	-	27	159	186
Arbëri	-	-	19	36	21	81	4	12	-	-	-	-	44	85	129
UBT	1877	3488	1176	2.930	984	2.521	-	40	-	-	-	-	4.037	4.942	8.979
Akademia Evolucion	130	159	149	174	144	186	-	-	-	-	-	-	423	96	519
Dardania	91	136	148	213	267	380	30	44	-	-	-	-	536	237	773
Biznesi	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
ESLG	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Globus	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Iliria	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Pjetër Budi	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Universi	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Universum	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Kosovo Art Academy	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Gjithsej	7.311	12.906	5.200	9.034	4.990	8.978	738	1.409	5	34	2	5	18.246	14.120	32.366

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018/19

Prapë se prapë, edhe në numrin e përgjithshëm të studentëve në nivelin bachelor 2018/2019 prapë universiteti i AAB-së më gjithsej 14,465 studentë. Edhe në vend të dytë prapë qëndron universiteti i UBT-së me gjithsej 8,979 studentë. Me pas në vend të tretë radhitet kolegji Fama me 2,793 studentë.

Tabela 5. Numri i studentëve të pranuar në nivelin Master në vitin 2018/2019

Kolegji	Femra	Meshkuj	Gjithsej
AAB	821	586	1407
AUK	11	13	24
Fama	11	10	21
Dukagjini	-	-	-
IBMC	-	-	-
ISPE	-	-	-
Juridika	6	13	19
QEAP Heimerer	-	-	-
Rezonanca	79	26	105
Riinvest	34	28	62
Tempulli	-	-	-
Arbëri	-	-	-
UBT	198	204	402
Akademia Evolucion	14	-	14
Dardania	7	8	15
Biznesi	:	:	:
ESLG	:	:	:
Globus	:	:	:
Iliria	:	:	:
Pjetër Budi	:	:	:
Universi	:	:	:
Universum	:	:	:
Kosovo Art Academy	:	:	:
Gjithsej	1.181	888	2.069

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018/19

Shumica e këtyre universiteteve përveq studimeve në ciklin bachelor, ofrojnë edhe studime të magjistraturës. Edhe në këtë sektor, AAB është universiteti i parë që ka të regjistruar 1,407 studentë për vijimin e studimeve të masterit për vitin akademik 2018/19. Me pas renditet universiteti i UBT-së me 402 të regjistruar. Ndërsa në vend të tretë vendoset universiteti i Rezonances me 105 studentë të regjistruar.

Tabela 6. Numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin master 2018/2019

Kolegji	Viti i studimeve				Femra	Meshkuj	Gjithsej
	I ^{rë}		II ^{të}				
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj			
AAB	821	586	413	200	1.234	786	2.020
AUK	-	-	11	13	11	13	24
Fama	11	10	59	55	69	65	134
Dukagjini	-	-	15	18	15	18	33
IBMC	-	-	-	-	-	-	-
ISPE	-	-	-	-	-	-	-
Juridika	6	13	5	3	14	16	30
QEAP Heimerer	-	-	-	-	-	-	-
Rezonanca	79	26	35	11	114	37	151
Riinvest	34	28	95	60	129	88	217
Tempulli	-	-	13	31	13	31	44
Arbëri	-	-	-	-	-	-	-
UBT	198	204	222	291	420	495	915
Akademia Evolucion	14	-	14	12	28	12	40
Dardania	7	8	-	-	7	8	15
Biznesi	:	:	:	:	:	:	:
ESLG	:	:	:	:	:	:	:
Globus	:	:	:	:	:	:	:
Iliria	:	:	:	:	:	:	:
Pjetër Budi	:	:	:	:	:	:	:
Universi	:	:	:	:	:	:	:
Universum	:	:	:	:	:	:	:
Kosovo Art Academy	:	:	:	:	:	:	:
Gjithsej	1.170	875	882	694	2.052	1.569	3.621

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018/19

Përsa i përket totalit të përgjithshëm të studentëve në nivelin master 2018/2019, rreth 2,020 studentë janë aktive në universitetin e AAB-së duke ndjekur studimet e ciklit të dytë, ndërsa 915 studentë janë pjesë e universitetit të UBT-së për të njëjtin qëllim. Gjithashtu, edhe në universitetin e Riinvest janë 217 studentë të ciklit të dytë, edhe pse ky numer i vogël në krahasim me dy universitetet e para, por nga ana tjetër një numër i përshtatshëm në krahasim me institucionet e tjera arsimore të paraqitura në tabelle.

Tabela 7. Numri i stafit akademik dhe administrativ sipas gjinisë 2018/2019

Kolegji	Të rregullt		Të angazhuar		Staf tjetër (administrativ)		Femra	Meshkuj	Gjithsej
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj			
AAB	-	-	-	-	-	-	-	-	-
AUK	7	9	7	3	40	37	54	49	103
Fama	31	77	8	35	13	1	52	113	165
Dukagjini	8	21	0	5	4	-	12	26	38
IBCM	5	7	2	2	10	8	17	17	34
ISPE	1	10	0	12	7	2	8	24	32
Juridika	3	18	1	12	5	2	9	32	41
QEAP Heimerer	38	46	23	29	4	-	65	75	140
Rezonanca	98	216	55	97	-	-	153	313	466
Riinvest	10	23	5	18	8	2	23	43	66
Tempulli	4	15	4	26	13	45	21	86	107
Arbëri	1	4	3	5	3	4	7	13	20
UBT	225	560	24	44	33	22	282	626	908
Akademia Evolucion	16	27	2	7	8	6	26	40	66
Dardania	25	58	16	42	8	4	49	104	153
Biznesi	:	:	:	:	:	:	:	:	:
ESLG	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Globus	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Iliria	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Pjetër Budi	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Universi	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Universum	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Kosovo Art Academy	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Gjithsej	472	1091	150	337	156	133	778	1561	2339

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018/19

Edhe pse universiteti AAB si në ciklin e parë, poashtu edhe në ciklin e dytë të studimeve ishte në vend të parë, prapë se prapë Agjencia e Statistikave të Arsimit në Kosovë nuk ka dhënë asnjë të dhënë të vetme siç edhe është e paraqitur më lartë. Megjithatë, prapë qëndron universiteti i UBT-së i cili përmban gjithsej 908 pjestarë të ndarë në stafin akademik dhe atë administrative. Me pas renditet universiteti i Rezonances me 466 dhe kolegji Fama me 165 pjestarë.

Tabela 8. Numri i përgjithshëm i stafit akademik nga jashtë vendit të cilët ligjërojnë në Kolegjet Private në vitin 2018/2019

Kolegji	Shqipëria		Maqedonia		Mali i Zi		Të tjerë		Gjithsej		
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Gjithsej
AAB	7	2	9	9	2	3	-	-	18	14	32
AUK	-	1	1	1	4	4	-	-	5	6	11
Fama	-	-	-	3	-	-	-	-	-	3	3
Dukagjini	-	-	-	2	-	-	-	-	-	2	2
IBCM	-	-	2	-	2	3	-	-	4	3	7
ISPE	-	2	-	2	-	-	-	-	-	4	4
Juridika	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
QEAP Heimerer	1	-	2	1	2	-	4	-	9	1	10
Rezonanca	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Rinvest	-	-	-	-	-	1	-	-	-	1	1
Arbëri	-	1	1	-	-	-	-	-	1	1	2
Tempulli	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
UBT	10	13	7	26	1	5	-	-	18	44	62
Akademia Evolucion	11	16	8	13	-	-	-	-	19	29	48
Dardania	47	104	-	-	-	-	-	-	47	104	151
Biznesi	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
ESLG	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Globus	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Iliria	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Pjetër Budi	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Universi	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Universum	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Kosovo Art Academy	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Gjithsej	76	139	30	57	11	16	4	-	121	212	333

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018/19

Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë gjithashtu kanë të punësuar edhe ligjërues (mësime dhënë) edhe nga vendet e huaja si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Amerika, Gjermania, etj. Nga të dhënat e publikuara nga ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës), këtë here në rend të parë vendoset universiteti i Dardanis-së me 151 pjesëtar të stafit akademik nga jashtë vendit të cilët ligjërojnë në këtë universitet. Më pas vije UBT me 62 ligjërues dhe Akademia e Evolucionit me 48 ligjërues jo-vendor.

2.3.3.1 Funksionet primare të këtyre institucioneve private arsimore

Sipas Valbona Fetiu- Mjeku (Arsimi Profesional), funksionet primare të institucioneve të lartë-përmendura janë:

- Të sigurojnë arsim në standardin universitarë
- Të ofrojnë lehtësira për inkurajim, studim dhe hulumtim
- Të shpërndajnë njohuri
- Të ofrojnë bursa studimi
- Të inkurajojnë përparimin dhe zhvillimin e njohurive
- Të zbatojnë praktikatat në qeveri, industri, tregti dhe komunitet
- Të sigurojnë kurse studimi ose udhëzimi, në nivele të arritjeve që konsiderohen të përshtatshme për të përmbushur nevojat e komunitetit
- Të sigurojnë lehtësira dhe burime për mirëqenien e stafit të Universitetit, studentëve dhe personave të tjerë që ndërmarrin kurse në Universitet (Instituti Gap)

2.3.3.2 Benchmarkingu në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë

Sipas Shafer dhe Coate, 1992, "Benchmarking është përkufizuar si një "proces i vazhdueshëm, sistematik për matjen dhe krahasimin e proceseve të punës së një organizate me ato të një organizate tjetër me qëllim të identifikimit të praktikave më të mira që mund të çojnë në përmirësime në operacionet dhe shërbimin ndaj klientit", (fq.31, par. 3). Edhe institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë aplikojnë mjaft hovshëm sistemin e krahasimit me qëllim të marrjes së informacionit të nevojshëm dhe përdorimit të tij për të identifikuar boshllëqet si dhe për të arritur një avantazh konkurrues. Zakonisht *Benchmarking-u* si dhe *Hulumtimi* janë dy terma që shumë shpesh ngatërrohen në praktike, andaj fillimisht lë të bëjmë një krahasim të detajuar të këtyre dy proceseve.

Tabela 9. Dallimet midis Benchmarking-ut dhe Hulumtimit

Benchmarking-u	Hulumtimi (Competitor Research)
Përqendrohet në praktikat më të mira	Përqendrohet në masat e performances
Përpiqet për përmirësim të vazhdueshëm	Përpiqet për përmirësim të shpejtë
Partnerizohet për të shkëmbyer informacione	Konsiderohet "spiunimi i korporatave"
Ruan një avantazh konkurrues	Thjesht një " e mire për tu pasur" si process
Bënë përshtatjen bazuar në nevojat e klientit pas ekzaminimit	Përpjeket për të pasqyruar një proces tjetër

Burimi: J. DeLayne Stroud, 2014.

Llojet e benchmarking-ut të cilat aplikohen nga institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë janë katër llojet vijuese si:

1. E brendshme
2. Konkurruese
3. Funksionale
4. Gjenerike

1. Benchmarkingu i Brendshëm

Është një standard krahauses i një procesi biznesi më një proces të ngjashëm brenda organizatës (The Economic Times, 2016). Institucionet arsimore në Kosovë aplikojnë mjaftueshëm këtë standard. Ato kanë marrë informacionet e nevojshme nga analizat e bëra përmes këtijë standardi duke tentuar për të fituar një avantazh konkurrues në treg. Kjo është edhe arsyeja përse sistemi i të mësuarit dhe i ligjërimit në universitete/kolegje ka një përputheshmëri mjaft të madhe me njëra- tjetrën. Arsyet përse universitetet në Kosovë përdorin këtë lloj të benchmarking-ut janë;

- ✓ Kosto efektive
- ✓ Aplikim relativisht i lehtë

- ✓ Aplikim relativisht i shpejtë
- ✓ Shkëmbimi i informacionit
- ✓ Pikënisje e shkëlqyeshme për studimet e ardhshme të krahasimit

2. Benchmarkingu Konkurrues

Cilësohet si një krahasim i drejtpërdrejtë i një procesi ose metode, produkti apo shërbimi (si p.sh. shërbimet universitare, proceset mësimore, etj). Ky krahasim më se shumti përdoret për të vlerësuar pozitën konkurruese që universiteti apo kolegji posedon në tregun arsimorë. Në bazë të identifikimit të pozitës konkurruese, atëherë krijohen dhe përdoren strategji efektive për ngritjen e performancës së institucionit (John,2017). Proceset mësimore, angazhimet e stafit akademik dhe administrative, mundësitë e punës praktike dhe asaj të rregullt, shpërblimi i studentëve të dalluar si dhe tërheqja e studentëve drejt universitetit/kolegjit janë temat për të cilat institucionet arsimore në Kosovë luftojnë në mënyrë të marrjes së informacioneve sekrete për njëra-tjetrën. Aq sa janë aktive në aplikimin e këtij standardi, institucionet duhet të jenë edhe të kujdesshme për arsye të disa paknaqësive të cilat mund të fitohen (shiko tabelën e paraqitur më poshtë).

Tabela 10. Përfitimet dhe sfidat e standardit krahasues

Përfitimet	Sfidat
Krahasimi i proceseve	Çështje të vështira juridike
Njeh më mirë konkurrencën tënde	Përmirësim relativisht i ulët i performancës
Partneritet i mundshëm	Sistem kërcënues
E dobishme për planifikimin dhe përcaktimin e qëllimeve	Mund të sigurojë informacione mashtruese
	Mund të sigurojë informacione mashtruese
	Konkurrentët mund të përfitojnë nga dobësitë tuaja

Burimi: www.isixsigma.com/methodology/benchmarking/understanding-purpose-and-use-benchmarking/

3. Benchmarkingu FunkSIONAL

Është një krahasim me proceset ose metodat të cilat janë të ngjashme ose identike (J. DeLayne Stroud, 2014). Përsa i përket këtij lloji të benchmarking-ut, pothuajse të gjitha institucionet e arsimit privat në Kosovë aplikojnë këtë standard për të identifikuar praktikatat që janë superiore në fushat funksionale. Institucionet private arsimore e përdorin këtë standard edhe për të fituar një avantazh konkurrues edhe me institucionet publike arsimore në vend. Edhe në Benchmarking-un FunkSIONAL egzistojnë benefitet dhe sfidat me të cilat një institucion arsimore mund të ballafaqohet (shiko tabelën e paraqitur më poshtë).

Tabela 11. Përfitimet dhe sfidat e standardit funksional

Përfitimet	Sfidat
Siguron informacione për trendin e industries	Kulturatat e ndryshme të korporatave
Mundeson krahasimet sasiore	Nevojë e madhe për specifikim
Shkalla e larte e përmirësimit	Funksionet e zakonshme mund të jenë të vështira për t'u gjetur
	Kërkon shumë kohë
	Vështiresi në vizualizim
	Vështiresi në përshtatjen e praktikave më të mira

Burimi: www.isixsigma.com/methodology/benchmarking/understanding-purpose-and-use-benchmarking/

4. Benchmarkingu Gjenerik

Ky standard mundëson krahasimin e proceseve dhe funksionve në industri të palidhura por të cilat mund të praktikohen njëjtë ose ngjajshem (J. DeLayne Stroud, 2014). Rolin kyq

në këtë standard e luan “të qenit inovativ” dhe fitimi i njohurve për proceset e punës. Përsa i përket këtijë procesi, nuk ka mjaft të dhëna sesi implementohet në institucionet e arsimit të lartë privat në Kosovë. Por ajo qfarë duhet ti kushtohet vëmendje janë avantazhet dhe disavantazhet që mund të shkaktoje ky standard (shiko tabelën e paraqitur më poshtë).

Tabela 12. Përfitimet dhe sfidat e standardit gjenerik


Përfitimet	Sfidat
Perspektivë e gjerë dhe e re	Koncept i vështirë
Të qenit inovativ	Kërkon shumë kohë për të planifikuar
Ekzaminon industri të shumta	Ndryshimet sasiore mund të sjellin rrezik të lartë
Krahasime te gjera	
Potencial i lartë për zbulim	

Burimi: www.isixsigma.com/methodology/benchmarking/understanding-purpose-and-use-benchmarking/

2.3.3.2.1 Metodologjia e krahasimit e aplikar nga institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë

Institucionet arsimore të nivelit të lartë në Kosovë (sektori privat), vendosin standarde për veten e tyre dhe matin proceset dhe performancën e tyre kundër konkurrentëve. Metodologjia të cilën e ndjekin institucionet kosovare është e paraqitur si më poshtë:

Figura 2. Metodologjia e krahasimit



Burimi: https://www.tutorialspoint.com/management_concepts/benchmarking_process.htm

- **Planifikimi**

Në fazën e planifikimit është e domosdoshme të identifikohen aktivitetet që duhet të përcaktohen. Që të arrihen matjet e krahasimit, inputet dhe rezultatet duhet të ripërcaktohen; aktivitetet e zgjedhura duhet të jenë të matshme dhe në këtë mënyrë lehtësisht të krahasueshme. Në mënyrë që lëshimet dhe gabimet të minimizohen, procese të tilla duhet të dokumentohen duke i mundësuar kompanisë të marrë një ide më të qartë për qëllimet e saja strategjike dhe proceset e saja parësore.

- **Mbledhja e informacionit**

Informacioni mund të klasifikohet përmes të dhënave parësore dhe të dhënave dytësore.

- **Analiza e të dhënave**

Pasi të mblidhen të dhëna të mjaftueshme, bëhet analiza e të dhënave. Analiza e të dhënave, prezantimi i të dhënave, parashikimi i rezultateve, klasifikimi i boshllëqeve të performancës janë vetëm disa nga pjesët përbërëse të këtijë seksioni.

- **Zbatimi**

Një plan veprimi që përkrahë ndryshimin duhet të formulohet në mënyrë sa më të saktë që të jetë e mundur por duke mbajtur në mend kulturën e organizatës. Gjithashtu duhet të sigurohet që menaxhmenti dhe stafi janë plotësisht të përkushtuar ndaj procesit si dhe që burime të mjaftueshme janë në dispozicion.


- **Kontrollimi**

Për të pasur një siguri më të madhe për arritjen e përfitimeve maksimale të procesit të krahasimit, një vlerësim sistematik duhet të bëhet rregullisht. Disa pjesë përbërëse të procesit janë; zotërimi i informacionit të kërkuar, vlerësimi i progresit të bërë, përsëritja e ndikimit të ndryshimeve dhe bërja e rregullimeve të nevojshme, etj (Kosovo Accreditation Agency).

Për ta kuptuar ende më shumë këtë metodologji, figura e mësipërme e cila përmban 5 faza të procesit të benchmarkingut është e ndarë në dy faza:

1. Faza e benchmarkingut
2. Faza pas benchmarkingut

Figura 3. Dy fazat e benchmarkingut



Burimi: <https://www.inspirage.com/services/management-consulting/supply-chain-benchmarking/>

Edhe kjo figurë paraqet kuptimin e njëjtë si në figurën numër 1, vetëm se është e përpiluar në detaje me specifike për ata të cilet dëshirojnë ta analizojnë procesin e benchmarkingut më thellësisht.

2.3.3.3 Ofrimi i shërbimeve në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë

Institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë ofrojnë një numër të madh të shërbimeve mbështetëse të cilat i ndihmojnë studentët për qdo problematike të hasur gjatë studimeve të tyre. Shërbimet shërbejnë edhe si ndihmesë mbështetëse edhe për problemet e mundshme të

natyrës akademike si dhe ato personale. Shërbimet e ofruara nga institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë ndahen në dy lloje:

1. Shërbimet studentore
2. Objektet e kampusit

Tani do të shpjegojmë të dy llojet e këtyre shërbimeve se bashku me pjesët e tyre përbërëse.

Shërbimet studentore

Tek shërbimet studentore, institucionet private të arsimit të lartë ofrojnë:

✓ **Njësia e aftësive të studimit**

Ky lloj shërbimi iu ndihmonë studentëve më këshillat e ndryshme për gjithqka akademike, si për shembull si duhet për të marrë shënime gjatë ligjeratave, si duhet të bëhen hulumtimet shkencore, si duhet shënuar referencat në mënyren sa më të saktë dhe si ti kompletojnë detyrat dhe projektet akademike me cilësi të lartë.

✓ **Programet e tutorizimit dhe mbështetjes**

Për studentët të cilët dëshirojnë të përmirësojnë performancën e tyre akademike, institucionet arsimore kanë krijuar seanca studimore të asistuar nga asistentët të fushave të ndryshme.

✓ **Zyra ndërlidhëse për studentët me aftësi të kufizuara**

Në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë janë present edhe studentë me aftësi të kufizuara. Në mënyre që ata të ndihen të njëjtë si studentët e tjerë pa ndonjë dallim të specifikuar, institucionet kanë krijuar një ambient mjaft të përshtatshëm duke iu ofruar atyre shërbime mbështetëse.

✓ **Zyra e këshillimit**

Në institucionet arsimore janë në dispozicion edhe zyrat e këshillimit në të cilat këshilltarët e trajnuar japin këshilla konfidenciale për studentët. Temat të cilat diskutohen janë të natyrave të ndryshme si probleme me studime, marrëdhëniet me profesorët, problemet e adaptimit me ambientin dhe rregullat e institucionit arsimor, etj.

✓ **Shërbimi i karrierës**

Studentet të cilët kanë pasiguri në përzgjedhjen e drejtimit dhe lëndëve, si dhe studentët të cilët janë në procesin e kërkimit të punës, ata i drejtohen zyrës së shërbimit të karrierës për të marrë këshilla dhe udhëzime.

✓ **Ndihma financiare**

Institucionet arsimore ofrojnë edhe këshilla financiare për studentët të cilët kanë probleme me buxhetimin, taksimin apo probleme të tjera financiare.

✓ **Shërbimi i akomodimit**

Zyra e shërbimit të akomodimit ju siguron studentëve informacione për të gjitha opsionet e mundshme të akomodimit si brenda poashtu edhe jashtë kampusit.

✓ **Klubet dhe shoqëritë**

Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë kanë të formuara klube të ndryshme në sistemin e tyre me qëllim që të inkurajojnë studentët të jenë aktiv edhe në mesin e shoqërisë.

✓ **Unioni Studentor**

Organizatat e drejtuara nga studentët në institucionet arsimore ndryshe quhen edhe Sindikatat Studentore. Këto sindikata llobojnë për të drejtat e studentëve dhe një varg çështjesh politike.

Objektet e kampusit

Tek objektet e kampusit, institucionet private të arsimit të lartë ofrojnë:

✓ **Bibliotekat**

Në institucionet arsmire bibliotekat janë të vendosura në vënde shumë të veqanta dhe të pajisura mirë me qëllim për ta bërë ende më të lehtë kryerjen e detyrave dhe mësimëve për studentët. Në shumicën e bibliotekave të arsimit privat në Kosovë janë të depozituara revista nga më të ndryshmet, DVD-të si dhe përdorim personal i internetit.

✓ **Kabinetet kompjuterike**

Kabinetet kompjuterike janë nevojë e veçantë për të përfunduar detyrat dhe hulumtime të ndryshme.

✓ **Objektet sportive**

Përveq hapësirave mësimore, institucionet ofrojnë gjithashtu edhe këndet e tjera argëtuese për studentët siç janë objektet e ndryshme sportive. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë përmbajnë fusha të gjalla lojrash, pishina, palestra dhe stadione të vogla që mund të përdoren në kohën e lirë ose për klubin sportiv të institucionit.

2.3.3.4 **Ndikimi i benchmarking-ut në përmisimin e shërbimeve**

Siç u cek edhe më lartë, Benchmarking-u është një metode shumë e mirë aplikative e cila përdoret për qëllim të përmiresimit të proceseve administrative si dhe atyre mësimore. Fillimisht ndihmon në ekzaminimin e proceseve, matjen dhe krahasimin e tyre ndërmjet institucioneve, duke sjellë një fokus të jashtëm në aktivitete, funksione ose operacione të brendshme. Me aplikimin e kësaj strategjie, institucionet e arsimit të lartë privat identifikojnë hapësirat e nevojshme për përmiresim dhe me pas i vendosin teknikat e tyre në praktike. Benchmarkingu iu ndihmon institucioneve private të arsimit të lartë në Kosovë në përmiresimin e shërbimeve të paraqitura me poshtë:

Tabela 13. Ndikimi i benchmarkingut në përmisimin e shërbimeve

SHËRBIMET ADMINISTRATIVE	SHËRBIMET STUDENTORE
SHËRBIMET FINANCIARE	AKTIVITETET DHE JETA STUDENTORE
Buxheti	Buxheti
Fushëveprimi i shërbimeve	Fushëveprimi i shërbimeve
Metrika e arkëtueshme të llogarive	
Metrika e porositjes së blerjes	
EFEKTIVITETI INSTITUCIONAL	ZYRA E PRANIMEVE
Aktivitetet e Zyrës dhe Prioritizimi	Buxheti
Fushëveprimi i shërbimeve (Kërkime institucionale, planifikim strategjik, akreditimi)	Fushëveprimi i shërbimeve
SHERBIMET E HULUMTIMIT	LIBRARIA
Buxheti për Mbështetjen e Fakultetit	Buxheti
	Fushëveprimi i shërbimeve
	Inventori
	Shitjet
Shërbime të tjera	Shërbime të tjera
Burimet njerëzore	Shërbimet e karrierës
Teknologjia e informacionit	Shërbime këshillimi
	Shërbimet e persona me aftësi të kufizuar
	Ndihma financiare
	Shërbimet shëndetësore
	Programet Ndërkombëtare

Burimi: <https://universitybenchmark.org/benchmarks>

KAPITULLI 3

METODOLOGJIA

3.1 Qëllimi hulumtimit

3.2 Qasja hulumtuese

3.3 Plani Kërkimor

3.3.1 Pyetëtori

3.3.2 Përzgjedhja e Mostrës

3.3.3 Procedura

3.4 Mbledhja e të Dhënave

3.5. Vlefshmëria dhe Besueshmëria

3.6 Rrethanat Limituese

3.1 Qëllimi hulumtimit

Si kurrë më parë, përmirësimi i performancës së universitetit është bërë një ndër çështjet më të diskutueshme ndërkombëtare si rezultat i rritjes së një mjedisi më të hapur dhe konkurrues të fushës arsimore. Për ta pasur këtë situatë nën kontroll, universitetet po aplikojnë metodën e krahasimit “Benchmarking-un”, si një proces të brendshëm organizativ i cili synon të përmirësojë performancën e organizatës duke mësuar për përmirësime të mundshme të proceseve. Rritja e krahasimit në arsimin e lartë pasqyron kërkimin për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë dhe për një mënyrë më efektive të përmirësimit të performancës në një sektor të arsimit të lartë shumë të larmishëm. Benchmarking gjithashtu shërben për nevojat e institucioneve individuale për të mësuar në mënyrë që të përmirësohen, të ndryshojnë dhe të menaxhojnë operacionet në një mënyrë më profesionale. Institucionet ambicioze zgjedhin krahasimin si një mjet për përmirësimin e pozitës së tyre në nivelin ndërkombëtar. Metoda e krahasimit identifikon boshllëqet në performancën arsimore dhe kërkon qasje të reja për përmirësime, monitoron përparimin, rishikon përfitimet dhe siguron adaptimin e praktikave të mira.

Andaj, qëllimi i këtijë projekti hulumtues është;


- Të shpjegojë pse, kur dhe si benchmarkingu i ndihmon institucionet arsimore që vazhdimisht të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të tyre duke rrespektuar standardin aktual
- Të shpalos se si metoda krahasuese iu lejon institucioneve arsimore monitorimin e performancës dhe menaxhimin me ndryshime: përkatesisht përfitimin e një perspektive të pavarur rreth performancës arsimore në krahasim me konkurrentet
- Të sqarojë se si institucionet e arsimit të lartë në Kosovë ofrojnë shërbimet studentore të nivelit ndërkombëtarë

3.2 Qasja hulumtuese

Tek qasja hulumtuese e cila është pjesa më e rëndësishme e seksionit të metodologjisë së projektit, janë të përmbledhura procedura, plane të përbëra dhe supozime të gjera për metodën e detajuar të mbledhjes, analizës dhe interpretimit të të dhënave (Chetty, 2018). Në këtë projekt hulumtues, qasja hulumtuese është ndarë në dy kategori:

1. Qasja e mbledhjes së të dhënave dhe
2. Qasja e analizës së të dhënave

Figura 4. Kategorite e qasjes hulumtuese



Burimi: <https://www.projectguru.in/publications/selecting-research-approach-business-studies/>

Duke filluar me pjesën e parë “koleksionimin e të dhënave”, në këtë punim për mbledhjen dhe organizimin e të dhënave janë përdorur llojet e mëposhtme (Gebreamlak, 2019):

- Mbledhja e mendimeve të pjesëmarrësve
- Përqendrimi në një koncept apo fenomen të vetëm
- Vërtetimi i saktësisë së gjetjeve

- Interpretimi i të dhënave
- Krijimi i një axhende për ndryshim ose reformë
- Bashkëpunimi me pjesëmarrësit
- Testimi ose verifikimi i teorive ose shpjegimeve
- Përdorimi i standardeve të vlefshmërisë dhe besueshmerisë
- Vëzhgimi dhe matja e informacioneve në mënyrë numerike
- Përdorimi i qasjes së pa-anshme
- Punimi në procedurat statistikore
- Mbledhja e të dhënave sasiore dhe cilësore
- Paraqitja e fotografive vizuale të procedurave në studim

Burimi: <https://humansofdata.atlan.com/>

Tek koleksionimi i të dhënave, hynë të dhënat sasiore dhe ato kualitative të paraqitura si më poshtë:

Tabela 13. Të dhënat sasiore dhe kualitative

	Qasje cilësore	Qasjet sasiore	Metodat e përziera (sasiore + cilesore)
Përdorimi i këtyre supozimeve filozofike	Pohime të njohurive konstruktive / transformuese	Pohime të diturisë post-pozitiviste	Pohime njohuri pragmatike
Aplikimi i këtyre supozimeve filozofike	Fenomenologjia, teoria e bazuar, etnografia, studimi i çështjeve dhe narracioni	Sondazhet dhe eksperimentet	Sekuenciale, e njëkohshme dhe transformuese

<p>Përdorimi i këtyre metodave</p>	<p>Pyetje të hapura-mbyllura, qasje në zhvillim, të dhëna teksti ose imazhi</p>	<p>Pyetje të mbyllura, qasje të paracaktuara, të dhëna numerike</p>	<p>Pyetje të hapura dhe të mbyllura, si qasjet e shfaqura ashtu edhe ato të paracaktuara, si dhe të dhëna dhe analiza sasiore dhe cilësore</p>
---	---	---	--

Burimi: Creswell, J.W., 2013. Research Design: Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods Approaches, SAGE Publications.

Ndërsa tek faza e dytë apo analiza e të dhënave, në këtë projekt hulumtues janë përdorur dy lloje të qasjes:

1. Qasja induktive
2. Qasja deduktive

Të dhënat cilësore janë ato lloj i të dhënave të cilat kërkojnë një qasje induktive të analizës ndërsa nga ana tjetër, të dhënat sasiore kërkojnë qasjen deduktive. Kurse tek të dhënat e përziera përdoret edhe qasja induktive edhe ajo deduktive.

Hulumtim cilësor (qasja induktive e analizës)

Qasja induktive në këtë punim hulumtues më se shumti është përdorur për leximin e detajuar të të dhënave sekondare për të nxjerrë koncepte, tema dhe modele (për analizimin e të dhënave cilësore). Kjo qasje pikë së pari fillon nga përzgjedhja e fushës së studimit dhe ndërton një teori (Jebreen 2012). Më fjalë të tjera, qasja induktive lejon të kuptohet se qëllimi i studimit është të kuptojë një fenomen.

Hulumtim sasior (qasja deduktive e analizës)

Hulumtimi sasiorë përdoret për analizimin e të dhënave statistikore me qëllim për të zbuluar lidhjen midis asaj që dihet dhe asaj që mund të mësohet nga hulumtimi i bërë në projekt. Sipas Trochim (2000), “statistikat përshkruese ndihmojnë për të tërhequr konkluzione në lidhje me popullatën dhe për të vlerësuar parametrat” (fq. 1, par.3). Nga kjo mund të kuptohet se qëllimi kyq i të dhënave sasiorë është për të vërtetuar hipotezat. Pra në këtë mënyrë, një hulumtues mund shumë lehtë të hartojë një kornizë teorike (hipotezë) dhe si përfundim ta testojë atë hipotezë duke nxjerre një përfundim specific (Soiferman 2010).

3.3 Plani Kërkimorë

Plani kërkimorë pikë se pari kontribuon në zhvillimin tuaj si hulumtues i cili paraqet një hartë për karrierën tuaj si një profesionist i shkencës kërkimore. Në këtë hartë të punimit përfshihen pyetësi, përzgjedhja e mostrës dhe procedura të cilat do të sqarohen ndaras si me poshtë.

3.3.1 Pyetësi

Pyetësi është një instrument hulumtues i konstruktuar nga një seri pyetjesh me qëllim të mbledhjes së informacionit nga të anketuarit. Procesi i hartimit të pyetësorit i cili është ndjekur për këtë projekt vijon si renditja e mëposhtme:


1. **Specifikoni informacionin e nevojshëm**
2. **Përcaktoni të intervistuarit e synuar**
3. **Specifikoni llojin e metodës së intervistimit** -Për këtë projekt janë përdorur dy lloje të intervistimit: mënyra ballë për ballë me intervistuesin dhe mënyra elektronike.
4. **Përcaktoni përmbajtjen e pyetjeve individuale:** Në këtë pyetësor janë përdorur *pyetje indirekte, direkte, dhe neutrale.*
5. **Pritshmëria për mos-përgjigje**- Pyetjet duhet të hartohen në një gjuhë të thjeshtë dhe të lehtë, në mënyrë që të kuptohen lehtësisht nga secili i anketuar.
6. **Vendosni për strukturën e pyetjeve**- Në pyetësor janë përdorur pyetje të strukturuar apo ndryshe të mbyllura ku janë të precaktuara të gjitha alternativat e përgjigjes.

7. **Përcaktimi i shënimit të pyetjeve**- Përmbajtja dhe struktura e pyetjeve është e ndërtuar në fjalë të cilat lehtë kuptohen nga të anketuarit.
8. **Përcaktimi rendor i pyetjeve**
9. **Përzgjedhja e formularit dhe paraqitjes së tij**
10. **Prezantimi i pyetësorit**

3.3.2 Përzgjedhja e Mostrës

Ndodh shumë shpesh që dy termat e njohur si popullësia dhe mostra të ngatërrohen në kontekstin e praktikimit të tyre. Andaj fillimisht do të spjegojmë dallimin mes këtyre dy terminologjive. Popullsia në një projekt hulumtues definohet si një grup i plotë elementësh që posedojnë një parametër të përbashkët midis tyre. Ndërsa mostra është një grup më i vogël elementësh apo thënë ndryshe është një nënbashkësi e gjithë popullatës. I gjithë ky spejgim është paraqitur grafikisht si mëposhte:

Figura 7. Popullsia dhe mostra



Burimi: <http://www.differencebetween.net/miscellaneous/difference-between-population-and-sample/>

Si mostër për këtë projekt hulumtues janë marrë studentët e institucioneve private të arsimit të lartë në Kosovë dhe përfaqesuesit e këtyre institucioneve.

3.3.3 Procedura

Për kontaktimin e të anketuarëve në këtë projekt janë përdorur dy lloje të intervistimit:

- Mënyra ballë për ballë me intervistuesin (*kontakti i drejtëpërdrejtë*)
- Mënyra elektronike

Studentët dhe përfaqesuesit e institucioneve arsimore janë vizituar në universitetet e tyre dhe fillimisht janë pyetur në mënyre vullnetare për të qenë pjesë e këtij studimi hulumtues. Ndërsa në intervistimin e mënyres elektronike, pyetësi është publikuar në ueb faqe dhe shpërndare tek studentët. Për regjistrimin e të dhënave të mbledhura nga intervistimi janë përdorur programet kompjuterike siq janë excel dhe word.

3.4 Mbledhja e të Dhënave

Mbledhja e të dhënave - është procesi i mbledhjes së të dhënave, matjes dhe analizës së tyre, duke përdorur teknika në përputhje me standarde të vlefshme (Cacioppo dhe Petty, 1982). Hulumtuesi në bazë të këtij procesi do të jetë në gjendje që të testoj hipotezën/at e paraqitur në punim. Në këtë punim janë aplikuar të dy llojet e të dhënave, të dhënat sekondare dhe ato primare. Të dhënat sekondare janë mbledhur nga regjistrimet, informacionet e mbledhura nga departamentet qeveritare, të dhënat organizative dhe të dhënat që fillimisht u mbledhën për qëllime të tjera kërkimore. Ndërsa si bazë për mbledhjen e të dhënave primare në këtë punim kanë qenë pyetësoret e realizuar tek mostra e përzgjedhur.

3.5 Vlefshmëria dhe Besueshmëria

Si bazë e metodologjisë kërkimore për kryerjen e hulumtimeve në këtë punim janë konsideruar vlefshmëria dhe besueshmëria. Projekti edhe në këtë aspekt ka dalë mjaft i suksesshëm pasi që në mënyre shumë të përshtatshme pyetësi i ka përmbushur 4 disiplinat e këtyre dy bazave siç janë:

- *Ndërshmeria*- studentët në mënyre vullnetare janë ftuar për të qenë pjesëmarrës në këtë punim. Në disa nga rastet e refuzimit të pjesëmarrjes në studim, studentet janë liruar nga angazhimi i metejëm.
- *Objektiviteti*- të gjithë pjesëmarrësit janë informuar se informacionet e dhëna nga ata do të përdoren vetëm për kompletimin e këtij punimi.
- *Qartësia*- të anketuarit janë informuar se përse po realizohet një studim i tillë.

- *Mirëbesimi*- të anketuarit janë informuar se përgjigjet e tyre nuk do të zbulohen pa pëlqimin e tyre.

3.6 Rrethanat Limituese

Vetëm dy kufizime studimore ndikuan në interpretimin e gjetjeve nga kërkimi i bërë. Këto kufizime ishin:

- Fillimisht kishte mungesa të të dhënave të disponueshme për temën e aplikuar. Nuk kishte statistika të detajuara dhe informacione relevante të cilat ishin mese të nevojshme për projektin. Të dhënat e disponueshme ishin të paraqitura më shumë si përmbledhje-pa dhënjën e detajeve.
- Disa kufizime u hasen edhe tek realizimi i marrjes së përgjigjeve nga të anketuarit pasi që një numër i tyre hezitan të plotësojnë pyetësonin, pavarësisht sigurisë dhe besueshmërisë së informacionit.

KAPITULLI 4

ANALIZA DHE KOMENTIMI I TE DHËNAVE


4.1 Analiza dhe komentimi i rezultateve

4.1 Analiza dhe komentimi i rezultateve

Ky seksion paraqet rezultatet nga metoda e anketimit. Siç edhe u përmend më herët, studentët në mënyrë vullnetare janë ftuar për të qenë pjesëmarrës në këtë punim. Në disa nga rastet e refuzimit të pjesëmarrjes në studim, studentet janë liruar nga angazhimi i mëtejshëm. Në këtë projekt hulumtues, pyetësorit iu përgjigjen 714 studentë. 321 studentë janë përgjigjur më intervistim të drejtëpërdrejtë, ndërsa 393 studentë janë përgjigjur me intervistim në formën elektronike.


Në vijim janë të paraqitura të gjitha të dhënat empirike me analiza dhe komente nga të anketuarit.

Grafiku 1. Struktura gjinore e të anketuarëve




Në këtë projekt hulumtues morën pjesë 423 studentë të gjinisë mashkullore apo 59%, ndërsa të gjinisë femërore morën pjesë 291 apo e shprehur në përqindje 41%.

Grafiku 2. Grupmosha e të anketuarëve




Grupe-moshat e të anketuarëve janë renditur në tre ndarje, siç është e paraqitur edhe në grafikun e mësipërmë. Duke u bazuar në rezultatet përfundimtare, rreth 31%, apo 223 prej të anketuarëve ishin të moshës 17-21, afër 42% ishin të moshës 22-25, dhe 26% apo 189 individë ishin mbi moshën 25 vjeqare.

Grafiku 3. Struktura etnike e të anketuarëve




Në pytesorë janë kyqur persona të shtetësive të ndryshme. Siç mund të shihet në grafikun, Republika se Kosovës dominonë në numër të cilit i përkasin 91% apo 652 individë. Të Republikës se Maqedonis i përkasin 5% apo në numër rreth 37 individë. Të Republikës se Shqipërisë i përkasin vetëm 4% apo në numër rreth 25 individë. Ndërsa opsioni i Republikës se Serbisë si dhe opsioni “tjetër” kanë rezultuar me 0%, apo thënë ndryshe me asnjë përgjigje të deklaruar në të.

Grafiku 4. Cili është viti juaj në universitet/kolegj?



Pas të dhënave personale të të anketuarëve, me pas vijojnë të dhënat kyçe për temën e projektit. Të anketuarit janë pyetur se në cilin vitit janë në studimet arsimore. Duke u bazuar në rezultatet e nxjerra, kemi arritur në përfundim se 234 individë apo 33% janë në vitin e parë. Rreth 245 individë apo 34% janë në vitin e dytë ndërsa 134 individë apo 19% janë studentë të vitit të tretë. Afër 78 individë apo 11% kanë pohuar për vitin e katërt ndërsa 23 individë apo vetë, 3% kanë përzgjedhur opsionin e “i/e diplomuar”. Opsion “tjetër” ka rezultuar pa asnjë përgjigje të vetme.


Grafiku 5. A jeni të kënaqur me stafin mësimor dhe metodat e tyre të mësimdhënies?



Studentet gjithashtu janë pyetur edhe për nivelin e kënaqësis që ata posedojnë me stafin mësimor dhe metodat e tyre të mësimdhënies. Nga rezultatet e nxjerra, 14% e studentëve (apo


99 studentë në numër) janë jashtëzakonisht të kënaqur me stafin mësimor dhe metodat e tyre të mësimdhënies. Rreth 40% e të anketuarëve (apo 285 studentë në numër) janë shumë të kënaqur ndërsa 21% (apo 153 studentë në numër) janë thjesht të kënaqur në këtë aspekt. Afër 17% (apo 123 studentë në numër) kanë qëndrim neutral në këtë pyetje ndërsa 4% (apo 32 studentë në numër) janë të pakënaqur me stafin mësimor dhe metodat e tyre të mësimdhënies. 3% (apo 21 studentë në numër) janë shumë të pakënaqur në këtë aspekt ndërsa 0% (apo 1 studentë në numër) janë jashtëzakonisht të pakënaqur me stafin mësimor dhe metodat e tyre të mësimdhënies.

Grafiku 6. Sa i plotësojnë klasat nevojat mësimore të studentëve?




Kur studentët janë pyetur se sa i plotësojnë klasat nevojat mësimore të tyre, rreth rreth 17% (apo 121 studentë në numër) kanë pohuar se klasat i plotësojnë nevojat mësimore të tyre jashtëzakonisht mire, ndërsa 44% (apo 317 studentë në numër) kanë pohuar për opsionin e “shumë mirë”. Afër 33% (apo 238 studentë në numër) janë përgjigjur me “mesatarisht mire” për këtë aspekt ndërsa vetëm 5% (apo 34 studentë në numër) kanë rrethuar opsionin “mirë”. Dhe së fundmi, vetëm 1% (apo 4 studentë në numër) kanë pohuar se klasat nuk plotësojnë nevojat mësimore të tyre.

Grafiku 7. Lehtësia e regjistrimit të kurseve të ndryshme brenda institucionit



A mendoni se është e lehtë të regjistroheni në kurse të ndryshme brenda institucionit tuaj, rreth 35% (apo 247 studentë në numër) kanë pohuar se është jashtëzakonisht e lehtë të regjistrohen në kurse të ndryshme brenda institucionit, kurse 44% (apo 317 studentë në numër) kanë pohuar për opsionin “shumë e lehtë”. Rreth 16% (apo 114 studentë në numër) janë përgjigjur me “disi e lehtë” ndërsa vetëm 4% (apo 32 studentë në numër) kanë rrethuar opsionin “jo aq e lehtë”. Dhe se fundmi, 1% (apo 4 studentë në numër) janë deklaruar se nuk është aspak e lehtë të regjistrohen në kurse të ndryshme brenda institucionit.

Grafiku 8. Dobishmeria e fakultetit dhe stafit mbështetës




Studentët janë pyetur gjithashtu edhe për dobishmerinë e fakultetit dhe stafit mbështetës dhe rreth 18% (apo 129 studentë në numër) kanë pohuar se niveli i fakultetit dhe stafit mbështetës në institucion është shumë i dobishëm, kurse 42% (apo 301 studentë në numër) kanë pohuar për nivel të dobishëm. Rreth 35% (apo 248 studentë në numër) kanë thjesht qëndrim neutral në këtë aspekt, ndërsa vetëm 4% (apo 32 studentë në numër) kanë rrethuar opsionin “nivel i padobishëm”. Së fundmi, 1% (apo 4 studentë në numër) janë deklaruar se niveli i fakultetit dhe stafit mbështetës në institucion është shumë i padobishëm.

Grafiku 9. A jeni të kënaqur me lehtësimet e siguruar nga institucioni?

	PO	JO	Totali
Librari	500	214	714
Laborator	612	102	714
Mensë	414	300	714
Konvikte	347	367	714
Kompleksi Sportiv	212	502	714


Për të krijuar një ambient më të përshtatshëm dhe më të mirë për studentët, institucionet e arsimit të lartë iu mundësojnë studentëve kyqje në librari, laboratorë, menzë, konvikte e kështu më radhë. Në pyetjen e paraqitur në grafikun e 9-të, ç’do i anketuar është përgjigjur për secilën kolone veqmas. Duke u bazur në rezultatet e nxjerrura nga pytësori, 500 studentë kanë pohuar se po, ata janë shumë të kënaqur me librarin e institucionit, ndërsa 214 studentë e kanë kundërshtuar këtë opsion. Rreth 612 studentë kanë theksuar se po, ata janë mjaft të kënaqur me laboratorët në institucionin e tyre, ndërsa 102 studentë kanë dhënë përgjigje negative në këtë aspekt. 414 studentë kanë pohuar se janë mjaft të kënaqur me mensën e institucionit, ndërsa 300 studene janë deklaraur me jo. Përsa i përket kolones se konvikteve, rreth 347 studentë kanë pohuar për po, se ata janë mjaft të kënaqur me konviktin e institucionit te tyre, ndërsa 367 e kanë kundërshtuar këtë. Dhe së fundmi, afër 212 studentë kanë thënë se po, ata janë shumë të kënaqur me kompleksin sportiv të institucionit të tyre, ndërsa 502 studentë kanë pohuar me jo, se ata nuk janë të kënaqur më këtë aspekt.

Grafiku 10. Niveli i kënaqësisë me pastërtinë dhe larminë e artikujve ushqimorë në institucion




Nga rezultatet e nxjerra, 16% e studentëve (apo 115 studentë në numër) janë jashtëzakonisht të kënaqur me pastërtinë dhe larminë e artikujve ushqimorë të disponueshëm në lokalin e institucionit të tyre. Rreth 21% e të anketuarëve (apo 149 studentë në numër) janë shumë të kënaqur ndërsa 35% (apo 252 studentë në numër) janë thjesht të kënaqur në këtë aspekt. Afër 18% (apo 127 studentë në numër) kanë qëndrim neutral në këtë pyetje ndërsa 5% (apo 36 studentë në numër) janë të pakënaqur me pastërtinë dhe larminë e artikujve ushqimorë të disponueshëm në lokalin e institucionit të tyre. 2% (apo 15 studentë në numër) janë shumë të pakënaqur në këtë aspekt ndërsa 3% (apo 20 studentë në numër) janë jashtëzakonisht të pakënaqur.

Grafiku 11. Çfarë mendoni për konviktin?




Nga rezultatet përfundimtare, rreth 14% (apo 101 studentë në numër) kanë pohuar se konvikiti i institucionit të tyre është tejte i mbushur me njerëz, ndërsa 32% (apo 230 studentë në numër) janë deklaruar se konvikiti është shumë i mbushur me njerëz. Afër 44% (apo 312 studentë në numër) kanë rrethuar opsionin e “disi i mbushur me njerëz”, ndërsa 10% (apo 69 studentë në numër) kanë përzgjedhur opsionin se konvikiti i institucionit të tyre nuk është edhe aq i mbushur me njerëz. Dhe se fundmi, 0% (apo 2 studentë në numër) kanë cekur se konvikiti i tyre nuk është aspak i mbushur me njerëz.

Grafiku 12. Sa ka të ngjarë të vazhdoni të ndjekni këtë institucion vitin e ardhshëm?




Studentët gjithashtu janë pyetur se a ka të ngjarë të vazhdojnë të ndjekni institucionin e tyre vitin e ardhshëm. Rreth 36% (apo 245 studentë në numër) kanë pohuar se është ekstremisht e mundshme të vazhdojnë të ndjekni institucionin e tyre vitin e ardhshëm, ndërsa 33% (apo 235 studentë në numër) kanë thënë se është e mundshme një gjë e tillë. Afër 28% (apo 202 studentë në numër) kanë thjesht qëndrim neutral në këtë aspekt, ndërsa 3% (apo 23 studentë në numër) kanë pohuar se nuk është edhe aq e mundshme një gjë e tillë. Dhe se fundmi, opsioni i “aspak e mundshme” nuk ka marrë as edhe një përgjigje të vetme.

Grafiku 13. Përvoja juaj e përgjithshme me institucionin



Nga rezultatet e nxjerra, 16% e studentëve (apo 114 studentë në numër) janë jashtëzakonisht të kënaqur në lidhje me përvojën e tyre të përgjithshme me institucionin e tyre. Rreth 20% e të anketuarëve (apo 146 studentë në numër) janë shumë të kënaqur ndërsa 30% (apo 217 studentë në numër) janë thjesht të kënaqur në këtë aspekt. Afër 26% (apo 189 studentë në numër) kanë qëndrim neutral në këtë pyetje ndërsa 4% (apo 26 studentë në numër) janë të pakënaqur në lidhje me përvojën e tyre të përgjithshme me institucionin e tyre. 1% (apo 10 studentë në numër) janë shumë të pakënaqur në këtë aspekt ndërsa 2% (apo 12 studentë në numër) janë jashtëzakonisht të pakënaqur.

Grafiku 14. A mendoni se familjaret ose miqtë tuaj do të përfitojnë duke studiuar në këtë institucion



Rreth 34% (apo 241 studentë në numër) kanë thënë që definitivisht po, familjarët ose miqtë e tyre do të përfitojnë duke studiuar në këtë institucion, ndërsa 56% (apo 402 studentë në numër) kanë pohuar me opsionin “me siguri, po”. Afër 5% (apo 33 studentë në numër) janë deklaruar se me sa duket familjarët ose miqtë e tyre nuk do të përfitojnë duke studiuar në këtë institucion, ndërsa 3% (apo 23 studentë në numër) kanë pohuar me “padyshim, jo”.

4.2 Rezultatet e pytësoreve të realizuar më përfaqësues të institucioneve private

Përveq pytësoreve të realizuar me studentët e institucioneve private të arsimit të lartë në Kosovë, gjithashtu janë realizuar edhe intervista me përfaqësues të këtyre institucioneve më qëllim që të shohim edhe pikëpamjet e tyre në raport me temën e aplikuar në këtë projekt. Pytëtori i përpiluar përmban gjashtë pyetje të tipit të hapur më qëllim të marrjes së përgjithshme të informacionit si dhe mos hezitimit për tu përgjigjur në pyetje. Përfaqësuesit janë vizituar fizikisht në vendin e tyre të punës për të realizuar intervistimin. Për çështje sigurimi dhe besimi, ata janë informuar se të gjitha të dhënat e mbledhura si pjesë e këtij pytësori do të shfrytëzohen vetëm për përgaditjen e raportit të sublimuar përfundimtarë.

Kolegji Heimerer

Intervista e parë është realizuar në Kolegjin Heimerer, me përfaqësuesen Jeta Loshaj. Në pyetjen se si i vlerësoni shërbimet e juaja universitare në krahasim me ato nderkombëtare, Jeta është përgjigjur se shërbimet e kolegjit Heimerer janë të një niveli të lartë cilësor pasi që ato janë të orientuara për nga niveli i universiteteve evropiane, e sidomos ato në Gjermani, pasi vete Kolegji është Gjermano-Kosovarë. Sa i përket shërbimeve administrative dhe akademike, ajo është shprehur se stafi administrativ dhe ai akademik *janë mjaft të angazhuar dhe gjithmonë në dispozicion t’u ndihmojnë dhe ti këshillojnë studentet. Për më shume, Jeta ka përmendur se mësimi është shumë i ndërlidhur me punën praktike. Edhe teoria është mjaft mirë e përfshire, por rëndesi e vecantë i kushtohet praktikës. Përveç kësaj, Kolegji ka projekte më të cilat*

bashkëpunon me partnere nga mbarë Evropa, ku janë të përfshirë edhe studentët (projekte në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësis). Se sa aplikohen “programet shkëmbimore të studentëve”, ajo ka cekur se kolegji ka partneritete mobiliteti me partnere nga 7 vende evropiane, si për staf, ashtu edhe për studentët. Disa nga vendet ku ata bëjnë programet shkëmbimore janë Finlanda, Turqia, Austria, Polonia, Gjermania dhe Belgjika. Dhe krejt në fund, Jeta ka deklaruar se benchmarkingu ndimon tej mase kolegjin, pasi që stafi e ka mundësinë të reflektoje mbi atë se ku mund të përmirësohet, dhe çfarë shërbimesh të rriten në rast se e sheh që ato shërbime po vlerësohen nga studentet.

Kolegji Universum

Arberita Beka, përfaqesuese e kolegjit Universum është shprehur se Kolegji Universum është kolegji më i ndërkombëtarizuar në vend. Ajo është shprehur se në bazë të komenteve ndërkombetare ne nuk po hasim në dallim me shërbimet në Universitetet tona partnere kudo në Evropë, pasi shërbimet administrative dhe akademike ofrohen me metodat më bashkëkohore. Sipas përfaqesueses, kolegji në cdo semester formulon pyetësor për vlerësimin e studentëve për cilësinë, stafin akademik & administrativ në mënyre që cdo here të përmbushim kërkesat dhe nevojat e studentëve. Universum ka mbi 78 universitete partnere nga Evropa më të cilat në mënyre të vazhdueshme bëjmë shkëmbime semestrale të studenteve. Dhe krejt në fund, Arberita ka deklaruar se me ndihmën e benchmarkingut dhe aplikim të tij në aktivitetet e këtij universiteti, studentet janë mjaft të kënaqur dhe kjo deshmohet edhe me besnikërinë që e tregojnë duke mbështetur cdo ngjarje dhe organizim të Kolegjit.

Kolegji AAB

Sipas Arbenita Krasniqi, reprezentatuse e kolegjit AAB, është institucioni i parë i arsimit në Kosovë i natyrës jopublike. Ky kolegji cilësohet si qendra me relevante akademike në vend dhe rajon i cili shërben si model i institucioneve të tjera arsimore. Arbenita ka cekur se kolegji AAB në vitin 2010 ka korrur një sukses të pazavendësueshëm duke u anëtarësuar si anëtar i rregullt në Magna Charta Universitatum. Përmes këtij antarësimi, AAB ka ndërtuar marrëdhëniet e forta të bashkëpunimit me më shumë se 750 universitete nënshkruese të këtij dokumenti. Përsa i përket

zhvillimit strategjik, ngritja dhe përmirësimi i cilësisë janë dy elementet kryesore të përkushtimit. Dhe krejt në fund, znj. Krasniqi ka deklaruar se me aplikimin e benchmarkinut, ky institucion tashmë ofron të gjitha programet në një nivel shumë cilësorë e të diversifikuar në Kosovë. Ajo gjithashtu shtoi se përmes monitirimit të përfomances dhe menagjimit me ndryshme, benchmarkingu na lejon të përmirësojnë rezultatet e aktiviteteve tona dhe ti krahasojme ato me atyre të konkurrenteve.

Kolegji Fama

Xhenita Podrimqaku Hoxha, përfaqesuese e kolegjit Fama tregon se ky institucion arsimor operon me simbiozen “aty ku jeni emër, e jo numër”. Në bazë të kësaj tipologjie, Fama fokusin primarë në aktivitetet e saja e ka arritjen e cilësisë arsimore sa më të lartë në vend. Fama ka realizuar një numër të madh të marrveshjeve me top universitetet ndërkombetare, ku një prej qëllimeve kyçe të këtyre marrveshjeve është mundësia e shkëmbimeve të studenteve. Disa nga marrveshjet e lidhura bashkëpunimi janë: Universiteti i Salzburgut, Universiteti i Ljubljanes, Universiteti Di San Marino – Itali, Universiteti i Sarajevës, Universiteti i Tiranës, Universiteti Cirili dhe Metodi, Universiteti European i Tiranës, Universiteti i Shkencave dhe Arteve “Georghe Cristea-Bukuresht, Rumania, HEDUCON – Hamburg (Germany), etj. Se fundmi, znj. Podrimqaku Hoxha ka përmendur se studentët janë shumë të kënaqur më shërbimet universitare që ju ofrohen atyre, dhe se benchmarkingu luan një rol te pazavendesushem në marrjen e vendimeve menagjieriale në aktivitetet universitare.

Kolegji Rezonanca

Për kolegjin Rezonanca është përgjigjur përfaqesuesja Liridona Shaqiri. Liridona ka cekur se kolegji Rezonanca siguron arsimim dhe kualifikim në të njejtin nivel me standardet Evropiane. Më fjalë të tjera ky institucion arsimor është lider në Ballkan për Shkenca Mjekësore si dhe është pjese e rrjetit Evropian të Kolegjeve të Shkencve Mjekësore. Një prej marrëveshjeve me të mira që ka nënshkruar ndonjëhere ky institucion arsimor është ajo e datës 20.05.2019 me Kompaninë Gjermane “ARTIGUM MANAGMENT” e cila marrëveshje ofron bursa për studentet më të dalluar,

bazuar në konkurse, sipas aplikimeve të përzgjedhura nga spitalet Gjermane. Kjo marrveshje ofron shërbimet më të mira dhe origjinale që dallojnë (jane unike) nga ato të universiteteve të tjera në vënd. Lirdona gjithashtu ka cekur se Rezonanca është pjesë e rrjetit të Alma Mater Europaea. Kjo pjesëmarrje i garanton institucionit studime cilësore dhe të pranueshme në të gjitha vendet e BE-së. Sipas perfaqesuese, ky institucion ofron dhe metoda efikase të vlerësimit sipas objektivave edukative. Dhe krejt në fund, Liridona ka përmendur se benchmarkingu si partner për të shkëmbyer informacione i mundeson kolegjit Rezonanca të siguron të dhënat me të vlefshme për teknologjinë e fundit duke u përqendruar në praktikat më të mira për të identifikuar praktikat e ardhshme për të ruajtur një avantazh konkurrues.

RIT Kosovo

Visar Jasiqi, perfaqesuese RIT Kosovo, ka deklaruar se RIT ne Kosove (A.U.K.), është i vetmi institucion privat i arsimit të lartë, jofitimprurës i gjithi në gjuhën angleze. Është gjithashtu institucioni i vetëm në Kosovë, gradat e të cilit janë të akredituara dhe të njohura në të gjithë botën falë partneritetit me Institutin e Teknologjisë Rochester (RIT) në New York. Organi studentor RIT Kosova (A.U.K) përbëhet nga studentë të ardhur nga 17 vende të ndryshme të botës. Çfarë e dallon këtë institucion privat arsimore nga të gjitha institucionet e tjera private dhe publike në vend është se RIT Kosova (A.U.K) jep të njëjtin standard të shkëlqyeshëm të arsimit të lartë amerikan, të cilin e marrin studentët RIT (të njëjtin grade dhe planprogram, të njëjtat provime dhe standarde të gradimit). RIT aplikon edhe kreditë e transferueshme dhe mundësitë studimore tërheqëse jashtë vendit. Studentët e RIT Kosova (A.U.K) mund të përfitojnë nga programet e ofruara të shkëmbimit dhe mund të transferojnë kreditë e tyre në çdo universitet tjetër në të gjithë botën. Ata mund të gëzojnë përfitimet e Programit Rol Global Scholar që ofron lëvizshmëri midis kampeve të tjera RIT në New York, Kroaci, Dubai dhe Kinë. Për më tepër, ata mund të bashkohen me programet tona të shkëmbimit si Erasmus me Universitetin HAMK (Finlandë), Sciences Po (Francë), ose ndonjë institucion tjetër që ofrojnë programe të përshtatshme për planin e studimit të studentëve.

Kolegji UBT

Arta Jusaj përfaqesuesja e kolegjit UBT thekson se UBT është zgjedhja më e mirë e qdo individi. Ky institucion privat arsimor është lider në Kosovë si në ofertat arsimore dhe cilësi, poashtu edhe në teknologji dhe inovacion. Në fakt është destinacioni primar në fushën e teknologjisë, biznesit dhe inxhinieris. Znj. Jusaj ka cekur se ajo qfarë e dallon këtë institucion nga të gjitha institucionet e tjera arsimore në vend është oferta arsimore dhe ajo e infrastruktures e cila është e vetmja e akredituar në nivel ndërkombëtar dhe e certifikuar për ekselence (EFQM) dhe ISO standard. Për më shumë, Jusaj ka përmendur se studentet përfitojnë nga mundësi shkollimi të avancuar dhe njohje ndërkombëtare të diplomave. Gjithashtu studentet kanë edhe mundësi transferi në rreth 250 universitete partnere në Bashkimin Evropian dhe SHBA.

KAPITULLI 5

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1 Përfundimet teorike

5.2 Përfundimet praktike

5.3 Rekomandimet

5.1 Përfundimet teorike

Përfundimi është gjithashtu një pjesë e veçantë e kapitullit të fundit të projektit sepse qëllimi i tij primarë është që të ndihmojë lexuesin të kuptoj qartë gjithë hulumtimin e bërë. Një përfundim i rregullt dhe i saktë nuk duhet të shkruhet vetëm si një përmbledhje e shkurtër e cila përmban në vetvete vetëm pikat kyçe të hulumtimit. Përfundimi duhet të shënohet në një, dy apo më shumë paragrafë – varesishtë prej temës se aplikuar- dhe të jetë i zhvilluar mirë dhe qartë.

Një përfundim i shkruar mirë përfshinë:

- Demonstrimin e fjalës së fundit për çështjet e ngritura në projektin hulumtues
- Përmbledhjen e mendimeve të hulumtuesit si dhe përcjellja e limitimeve/implikimeve gjatë procesit të hulumtimit
- Paraqitjen e ideve

Pas hulumtimeve të dhënave sekondare, arritëm në përfundim të nxjerrim se Benchmarkingu përdoret për të përmirësuar proceset administrative, shërbimet universitare si dhe modelet mësimore në kolegje dhe universitete. Qëllimi kryesor i aplikimit të kësaj metode në institucionet e arsimit private në Kosovë është të sigurojë personelin kryesor përgjegjës për proceset si dhe të formoj një kriter të jashtëm për matjen e cilësisë dhe kostos së aktiviteteve të brendshme. Për më shumë, kjo metode krahasuese ndihmon të identifikoj hapësirat për përmirësim. Rritja e “krahasimit” në arsimin e lartë pasqyron kërkimin për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë dhe për një mënyrë më efektive të përmirësimit të performancës në një sektor të arsimit të lartë shumë të larmishëm. Benchmarking-u gjithashtu shërben për nevojat e institucioneve individuale për të mësuar se si të përmirësohen, të ndryshojnë dhe të menaxhojnë operacionet në një mënyrë më profesionale.

Benchmarking-u si një metode mjaft efektive krahasuese, mundëson ndarjen e strukturuar të ideve dhe praktikave të mira mbi pikat e forta dhe të dobëta institucionale. Nëse një institucion arsimor posedon informacionin mbi performancën aktuale institucionale dhe cilësinë e procesit të ndërkombëtarizimit, atëherë ai institucion do të posedoj mundësi ende më të mira për zhvillimin e strategjive adekuate institucionale. Në këtë mënyre, institucioni do të mbaj nivel më

të lartë të ndërgjegjësimit, dukshmërisë, profilit institucional, reputacionit dhe fitimit të një avantazhi të fortë konkurrues.

Këto informacione vërtetojnë hipotezen 1, 2 dhe 3 të paraqitur në kapitullin e parë të punimit. Gjithashtu, aplikimi i Benchmarking-ut në mënyren e duhur iu ndihmonë institucioneve arsimore të:

- Vetëvlerësojnë institucionin e tyre
- Kuptojnë proceset e formulimit dhe zbatimit të strategjisë
- Fitojnë informacion dhe të dhëna në lidhje me veten dhe institucionet e tjera për të mbështetur vendimmarrjen
- Identifikojnë fushat për përmirësim
- Vendosin objektiva për zhvillimet institucionale

5.2 Përfundimet praktike

Pas realizimit të pytësoreve dhe përmbledhjes së përgjigjeve nga të anketuarit, si përfundim kemi nxjerrur edhe përfundimet praktike.

Tek pytësori i realizuar tek studentët, pjesa më e madhe e të anketuarëve ishin të gjinisë mashkullore të grupëmoshës 22 - 25 vjeqare, ku rreth 91% ishin te Republikës së Kosovës, ndërsa 9% (pjesa e mbetur e të anketuarëve ishin të nënshtetësive tjera). Sipas deklarimeve të tyre të bëra në pytësore, pjesa më e madhe e studentëve (apo 34%) të cilët zgjedhën që të jenë pjesë e këtijë projekti ishin studentë të vitit të dytë. Studentët pohuan se ata më të vërtet janë jashtëzakonisht të kënaqur me stafin mësimor dhe metodat e tyre të mësimdhënies. Gjithashtu, ata theksuan se klasat e universitetit si dhe renditja e tyre strukturore përmbushë në mënyre të kënaqshme nevojat mësimore të studentëve. Studentët ceken edhe se në institucionet e tyre arsimore është e lehtë të regjistrohen në kurse të ndryshme brenda institucionit. Sipas deklarimeve të bëra u vërtetua se fakulteti dhe stafi mbështetës në institucione është mjaft i dobishëm dhe se studentët janë shumë të kënaqur me lehtësirat e siguruara nga institucionet (librari, laboratorë, mensë, konvikte, komplekse sportive, etj). Këto lehtësirat të siguruara nga institucionet

vërtetojnë hipotezën nr.4 e paraqitur në kapitullin e parë të punimit e definuar si *“Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë ofrojnë shërbime studentore të nivelit ndërkombëtare”*. Një gjë e cila ishte pak shqetësuese për studentët, ishte se sipas tyre konviktet janë të mbushura më shumë njerëz, gjë e cila pengon qetësinë. Prapë se prapë, ata theksuan se përsëri do të vazhdojnë të ndjekin të njëjtin institucion arsimor edhe vitin e ardhshëm dhe se familjarët apo miqët e tyre do të përfitojnë shumë duke studiuar aty.

Tek pyetësi i realizur tek përfaqësuesit e institucioneve, të gjitha institucionet private arsimore ofrojnë arsimim dhe kualifikim në të njëjtin nivel me standardet evropiane. Në fakt sipas deklaramëve të përfaqësuesëve, stafi menagjues ka rolin kyq në aplikimin e benchmarkingut ku përmes tij tentohet përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve universitare të ofruara duke respektuar standartet aktuale. Në fakt, përfaqësuesit kanë deklaruar se benchmarkingu i ndihmon tej mase institucionet, pasi që stafi e ka mundësinë të reflektoje mbi atë se ku mund të përmirësohet, dhe çfarë shërbimesh të rriten në rast se e sheh që ato shërbime po vlerësohen nga studentet. Këto të dhëna vërtetojnë hipotezën nr.1 e paraqitur në kapitullin e parë të punimit e definuar si *“Benchmarking ndihmon institucionet arsimore që vazhdimisht të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të tyre: institucionet respektojnë standardin aktual, dhe pastaj përpiqen ta tejkalojnë atë”*. Gjithashtu, ato aplikojnë shumë edhe shkëmbimet studentore në universitetet më të njohura botërore si: Universiteti i Salzburgut, Universiteti i Ljubljanes, Universiteti Di San Marino – Itali, Universiteti i Sarajevës, Universiteti Cirili dhe Metodi, etj. Këto institucione arsimore qdo vit rritin numrin e marrëvrvshjeve ndërkombëtare duke përfituar ende me shumë në zhvillimin universitar. AAB ka ndërtuar marrëdhëniet e forta të bashkëpunimit me më shumë se 750 universitete nënshkruese, ndërsa UBT më rreth 250 universitete partnere në Bashkimin Evropian dhe SHBA. Për sa i përket benchmarking-ut, nga përgjigjet e dhëna nga përfaqësuesit e universiteteve, u përmbledh se benchmarkingu luan një rol të pa-zavendësueshem tek institucionet arsimore private të arsimit të lartë. Benchmarkingu në këto institucione arsimore cilësohet si partner për të shkëmbyer informacione duke iu siguruar atyre të dhënat më të vlefshme për teknologjinë e fundit duke u përqendruar në praktikat më të mira për të identifikuar praktikat e ardhshme dhe për të ruajtur avantazhin konkurrues. Këto të dhëna

vërtetojnë hipotezën nr.2 e paraqitur në kapitullin e parë të punimit e definuar si *“Benchmarking-u iu siguron institucioneve arsimore të dhënat me të vlefshme për teknologjinë e fundit dhe proceset e ndjekura në mjedisin e tyre”*.

Gjithashtu, benchmarkingu iu mundëson institucioneve arsimore që të diferencohen nga njëra-tjera në shumë aktivitete dhe veprimtari universitare duke i lejuar atyre të ofrojnë programe mësimore të ndryshme në një nivel shumë cilësorë e të diversifikuar në Kosovë. Në fakt, përmes monitirimit të performancës dhe menagjimit me ndryshme, benchmarkingu i lejon institucionet arsimore të përmirësojnë rezultatet e aktiviteteve të tyre si dhe të krahasojme ato me atyre të konkurrenteve. Këto të dhëna vërtetojnë hipotezën nr.3 e paraqitur në kapitullin e parë të punimit e definuar si *“Benchmarkingu i lejon institucioneve arsimore monitorimin e performancës dhe menaxhimin me ndryshime: përkatesisht përfitimi i një perspektivë të pavarur rreth performancës arsimore në krahasim me konkurrentet”*.

5.3 Rekomandimet

Institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë ofrojnë një numër të madh të shërbimeve mbështetëse të cilat i ndihmojnë studentët për çdo problematike të hasur gjatë studimeve të tyre. “Shërbimet” shërbejnë edhe si ndihmese mbështetëse edhe për problemet e mundshme të natyrës akademike si dhe ato personale. Shërbimet e ofruara nga institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë ndahen në dy lloje:

<i>Shërbimet studentore</i>	<i>Objektet e kampusit</i>
<i>Njësia e aftësive të studimit</i>	Bibliotekat
<i>Programet e tutorizimit dhe mbështetjes</i>	Kabinetet kompjuterike
<i>Zyra ndërlidhëse për studentët me aftësi të kufizuar</i>	Objektet sportive
<i>Zyra e këshillimit</i>	
<i>Shërbimi i karrierës</i>	
<i>Ndihma financiare</i>	
<i>Shërbimi i akomodimit</i>	
<i>Klubet dhe shoqëritë</i>	
<i>Unioni Studentor</i>	

Duke marrë në konsideratë rezultatet praktike si dhe ato teorike, që një institucion arsimor të zhvillohet në mënyrë të rregullt në fushën e arsimit si dhe të fitojë avantazh konkurrues në treg, atëherë do ishte mëse e nevojshme që të ndjek rekomandimet e poshtë-shënuara:

1. Identifikoni burimin e pakënaqësisë se studentëve

Institucioni duhet që të sigurojë infrastrukturë mjaft të përshtatshme për studentët si dhe të ju ofroj atyre shërbime mbështetëse studentore në kampus. Gjate ofrimit të shërbimeve, stafi institucional duhet të zbulojë se cilat janë knaqësit dhe paknaqësit studentore, duke identifikuar nivelin në të cilën studenti gëzon të gjitha aspektet e jetës në kampus.

2. Bashkëpunimi me i ngushtë me studentët

Institucionet arsimore në Kosovë duhet që të ndihmojnë studentët të cilët përballen me vështiresi akademike dhe tutorizimit. Kështu, institucionet duhet të sigurohen që studentët po lidhen dhe bashkëpunojnë me fakultetin në mënyrë efektive, duke ofruar njoftime dhe shërbime të mesazheve mbi aktivitetet akademike. Ky lloj bashkëpunimi mund të përmirësoj përvojën e të mësuarit të studentëve duke iu lehtësuar atyre vështiresit apo probleme të tilla universitare.

3. Proceset drejtuese

Institucionet duhet të përmirësojnë shërbimet mbështetëse për të ndjekur aktivitetet e studentëve. Gjithashtu, një nevojë esenciale është edhe përmirësimi i atyre mungesave të cilat mund të jenë presente në drejtimin e proceseve administrative dhe akademike.

4. Aplikimi i teknologjise rreth institucionit

Si gjithmonë, studentët duan dhe kanë nevojë të jenë në qasje informative gjatë gjith kohës për rreth orareve, kurseve, planeve mësimore, burimeve bibliotekare, detyrave, etj. Andaj shfrytëzimi teknologjisë celulare do të siguroj të gjithë informacionin që studentët duan.

5. Të nxisë lidhje më të forta midis studentëve, fakulteteve dhe stafit

6. Krijimi i më shumë mundësive për zhvillimin e udhëheqjes së studentëve

7. Rritja e bashkëpunimit nëpër departamente

8. Lehtësoni bashkëpunime më të mira ndërmjet këshilltarëve të pranimit, këshilltarëve, trajnerëve të suksesit dhe stafit tjetër të shërbimeve mbështetëse

9. Trajnime studimore dhe seminare

Institucionet duhet të ofrojnë seminare të aftësive të studimit dhe kurse trajnimi për t'u mësuar studentëve strategji efektive të rishikimit dhe menaxhimit të kohës.

10. Inkurajimi i grupe zyrtare dhe informale të studimit midis studentëve

11. Organizimi i ngjarjeve për studentët dhe fakultetet për të bashkëvepruar jashtë mjedisit të klasës

12. Këshillimi për karrierë duhet të fillojë herët, në mënyrë që t'i ndihmojë studentët të planifikojnë pjesën akademike të rrugëve të tyre të karrierës

13. Shërbime mbështetëse gjithëpërfshirëse

Regjistrimi i kurseve, sigurimi i ndihmës financiare, zhvillimi i aftësive të studimit, zotërimi i materialit të lëndëve të vështira - studentët duhet të kapërcejnë një larmi të gjerë pengesash në rrugën e diplomimit. Shërbimet studentore që synohen dhe shpërndahen në mënyrë efektive në kohën e duhur mund të bëjnë shumë për të ndihmuar studentët të prodhojnë rezultate më të mira.

14. Identifikimi dhe synimi i faktorëve rrezikues për studentët

Identifikimi i studentëve që janë në rrezik të braktisjes së institucionit duhet të bëhet me kohë në mënyrë që një gjë e tillë të parandalohet para se të zhvillohet me shumë.

15. Sigurimi i fleksibilitetit përmes shërbimeve dixhitale

Kur institucionet ofrojnë shërbime të tilla si këshillimi, këshillimi dhe ndihma financiare vetëm përmes takimeve ballë për ballë gjatë orarit normal të punës, studentët që kanë punë, familje dhe përgjegjësi të tjera jashtë kampusit janë më pak të përshtatshme për të përfituar prej tyre.

16. Partneritete strategjike të jashtme

Institucionet duhet të krijojnë marrëdhënie me entitetet e jashtme për të iu ofruar studentëve përparësi në karrierën e tyre akademike dhe më gjerë.

Referencat

Cacioppo, J. T., & Petty, R. E. (1982). The need for cognition. *Journal of Personality and Social Psychology*, 42, 116–131.

Creswell, J.W., 2013. *Research Design: Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods Approaches*, SAGE Publications.

Chetty, Priya. "Importance of Research Approach in a Research." *Knowledge Tank*, 7 Dec. 2018, www.projectguru.in/publications/selecting-research-approach-business-studies/.

Daka, Sokol. "Kosovo Accreditation Agency." *Higher Education Institutions in Kosovo*, www.akreditimi-ks.org/new/index.php/en/download/higher-eduacion-institutions.

De la Fuente, A. and Ciccone, A. (2002) *Human Capital in a Global and Knowledge-based Economy*, Report for DG Employment and Social Affairs, Brussels: European Commission.

European Training Foundation (2009). 'Country plan – Kosovo. Working paper', [http://www.etf.europa.eu/pubgmt.nsf/%28getAttachment%29/216A59B612479784C12575390037B435/\\$File/NOTE7N5DW9.pdf](http://www.etf.europa.eu/pubgmt.nsf/%28getAttachment%29/216A59B612479784C12575390037B435/$File/NOTE7N5DW9.pdf)

Gebreamlak, et al. "Your Guide to Qualitative and Quantitative Data Analysis Methods - Atlan: Humans of Data." Atlan, 12 July 2019, humansofdata.atlan.com/2018/09/qualitative-quantitative-data-analysis-methods/.

Gjinovci, Rron. "Ndihamoni Arsimin Në Kosovë - Kosovo 2.0Kosovo 2.0." *Kosovo 2.0*, 11 Feb.

2019, kosovotwopointzero.com/help-education-in-kosovo/.

Hoxha, Edmond R. (2008). STANDARTET ARSIMORE NE BASHKIMIN EUROPIAN DHE NE

SHQIPERI (Education standards in EU and Albania).

Fetiu- Mjeku , Valbona. “Arsimi Profesional.” *MASHT*, masht.rks-gov.net/arsimi-profesional.

Fodell, Dianne. Spohrer, Jim. and Murphy, Wendy et al. “Ten Reasons Service Science Matters

to Universities.” *EDUCAUSE Review*, 1AD, [er.educause.edu/articles/2012/11/ten-](http://er.educause.edu/articles/2012/11/ten-reasons-service-science-matters-to-universities)

[reasons-service-science-matters-to-universities](http://er.educause.edu/articles/2012/11/ten-reasons-service-science-matters-to-universities).

Harrison, Dianne F. “The Role of Higher Education in the Changing World of Work.”

EDUCAUSE Review, 23 Oct. 2017, [er.educause.edu/articles/2017/10/the-role-of-higher-](http://er.educause.edu/articles/2017/10/the-role-of-higher-education-in-the-changing-world-of-work)

[education-in-the-changing-world-of-work](http://er.educause.edu/articles/2017/10/the-role-of-higher-education-in-the-changing-world-of-work).

H. De Ridder-Symoens, W. Rüegg. “A history of the university in Europe” Cambridge

University Press (1992), 16 Oct 2003.

Hoti, A. dhe Adnett, N. (2004) Schooling in a High Unemployment Economy: The case of

Kosova; Staffordshire University Business School, Economics Division, Working Paper

Nr. 2004.01.

Instituti Gap për studime të avancuara, “Pasqyrë e Arsimit të Lartë Privat në Kosove”, (fq.14).

J. DeLayne Stroud. “Understanding the Purpose and Use of Benchmarking.” *ISixSigma*, 29 Oct.

2014, www.isixsigma.com/methodology/benchmarking/understanding-purpose-and-use-benchmarking/

Jebreen, I., 2012. Using Inductive Approach as Research Strategy in Requirements Engineering.

International Journal of Computer and Information Technology, 01(02), pp.162–173.

Spacey, John. “7 Types of Competitive Benchmarking.” *Simplicable*, 27 Apr. 2017, simplicable.com/new/competitive-benchmarking.

KOHA.net. “Statistikat e Arsimit Në Kosovë.” KOHA.net, Koha.net, 18 June 2018,

www.koha.net/arberi/99959/statistikat-e-arsimit-ne-kosove/.

BARLOW, LISA. “Sample Essay on the Importance of Education in the Person`s Life.”

BuyEssayFriend.com, 26 Oct. 2017, buyessayfriend.com/essay-on-education.

OECD (2003a) Reviews of National Policies for Education: South Eastern Europe Volume 1,

Paris: OECD.

Online, ET. “Internal Benchmarking.” *The Economic Times*, Economic Times, 13 Apr. 2016,

economictimes.indiatimes.com/i/internal-benchmarking/articleshow/51808912.cms.

Reddy, Chitra. “Why Education Is Important? Top 13 Reasons.” WiseStep, 19 June 2019,

content.wisestep.com/education-important-top-reasons/.

Soiferman, K.L., 2010. Compare and Contract Inductive and Deductive Research Approaches.

University of Manitoba.

Sudman, S. and Bradburn, N. M. (1973), *Asking Questions*, pp. 208 - 28.

Shafer, Barbara S., and L. Edwin Coate. 1992. Benchmarking in higher education: A tool for

improving quality and reducing cost. *NACUBO Business Officer* (November): 28–35.

“The Importance of Higher Education in the 21st Century.” Vista College, 4 Dec. 2018,

www.vistacollege.edu/blog/resources/higher-education-in-the-21st-century/.

“The Importance of Higher Education in the 21st Century.” Vista College, 4 Dec. 2018,

www.vistacollege.edu/blog/resources/higher-education-in-the-21st-century/.

Valeroa, Anna, and John Van Reenenb. “The Economic Impact of Universities: Evidence from across the Globe.” *Economics of Education Review*, Pergamon, 14 Sept. 2018,

www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0272775718300414.

Veseli, Luljeta Krasniqi -. “Universitetet e Paakredituara Kanë Një Vit Afat Të Rrisin Cilësinë.”

Radio Evropa e Lirë, Radio Evropa e Lirë, 16 July 2019,

www.evropaelire.org/a/universitetet-akreditimi-kosova/30058451.html.

World Bank (2000a). „World Bank contract between UNMIK and the Council of Europe for

Technical Assistance for the Development of the University of Prishtina/Kosovo”

(mimeo).

World Bank (2002b). *Constructing Knowledge Societies: New Challenges for Tertiary*

Education. Washington: the World Bank.

https://www.tutorialspoint.com/management_concepts/benchmarking_process.htm

<https://www.inspirage.com/services/management-consulting/supply-chain-benchmarking/>

<https://universitybenchmark.org/benchmarks>

Shtojcat

Appendix#1: Pytësori

1. Gjinia juaj:

- a) Mashkull
- b) Femër

2. Mosha Juaj:

- a) 17-21
- b) 22-25
- c) Mbi 27

3. Cila është shtetësia juaj:

- a) Republika e Kosovës
- b) Republika e Maqedonisë
- c) Republika e Shqipërisë
- d) Republika e Serbisë
- e) Tjetër (ju lutem specifikoni) _____

4. Cili është viti juaj në universitet/kolegj?

- a) Viti i parë
- b) Vitit i dytë
- c) Viti i tretë
- d) Viti i katërt
- e) I diplomuar
- f) Tjetër (ju lutem specifikoni) _____

5. A jeni të kënaqur me stafin mësimor dhe metodat e tyre të mësimdhënies?

- a) Jashtëzakonisht i kënaqur
- b) Shumë i kënaqur
- c) I kënaqur
- d) Neutral
- e) I pakënaqur
- f) Shumë i pakënaqur
- g) Jashtëzakonisht i pakënaqur

6. Sa i plotësojnë klasat e universiteti/kolegjit tuaj nevojat mësimore të studentëve?

- a) Jashtëzakonisht mirë
- b) Shumë mirë
- c) Mesatarisht mirë
- d) Mirë
- e) Aspak mirë

7. A mendoni se është e lehtë të regjistroheni në kurse të ndryshme brenda institucionit?

- a) Jashtëzakonisht e lehtë
- b) Shumë e lehtë
- c) Disi e lehtë
- d) Jo aq e lehtë
- e) Aspak e lehtë

8. A mendoni se fakulteti dhe stafi mbështetës në institucion është i dobishëm?

- a) Shumë i dobishëm
- b) I dobishëm
- c) Neutral
- d) I padobishëm
- e) Shumë i padobishëm

9. A jeni të kënaqur me lehtësimet e siguruara nga institucioni?

- a) Librari Po/Jo
- b) Laborator Po/Jo
- c) Mensë Po/Jo
- d) Konvikte Po/Jo
- e) Kompleksi Sportiv Po/Jo

10. Sa jeni të kënaqur me pastërtinë dhe larminë e artikujve ushqimorë të disponueshëm në lokalin e institucionit tuaj arsimorë?

- a) Jashtëzakonisht i kënaqur
- b) Shumë i kënaqur
- c) I kënaqur
- d) Neutral
- e) I pakënaqur

- f) Shumë i pakënaqur
- g) Jashtëzakonisht i pakënaqur

11. Çfarë mendoni për konviktin?

- a) Tejet i mbushur me njerëz
- b) Shumë i mbushur me njerëz
- c) Disi i mbushur me njerëz
- d) Jo aq i mbushur me njerëz
- e) Aspak i mbushur me njerëz

12. Sa ka të ngjarë të vazhdoni të ndjekni këtë institucion vitin e ardhshëm?

- a) Ekstremisht e mundshme
- b) Shumë e mundshme
- c) Neutral
- d) Jo aq e mundshme
- e) Aspak e mundshme

13. Po në lidhje me përvojën tuaj të përgjithshme me këtë institucion?

- a) Jashtëzakonisht i kënaqur
- b) Shumë i kënaqur
- c) I kënaqur
- d) Neutral
- e) I pakënaqur
- f) Shumë i pakënaqur
- g) Jashtëzakonisht i pakënaqur

14. A mendoni se familjarët ose miqtë tuaj do të përfitojnë duke studiuar në këtë institucion?

- a) Definitivisht po
- b) Me siguri, po
- c) Me sa duket, jo
- d) Padyshim, jo
- e) Nuk kam përgjigje

Appendix#2: Pytësori

Emri dhe Mbiemri _____

Institucioni Arsimor _____

Ky pyetësor është përpiluar dhe shpërndarë për nevojat e përgaditjes së temës së magjistratures me titull “NDIKIMI I BENCHMARKING-UT NË PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE NË INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË”. Të gjitha të dhënat e mbledhura si pjesë e këtij pyetësori do të trajtohen si anonime dhe do të shfrytëzohen vetëm për përgaditjen e raportit të sublimuar përfundimtarë.

Paraprakisht, ju falenderojmë për bashkëpunimin, i cili do të jetë kyq për suksesin e këtij punimi.

1. Si i vlerësoni shërbimet e juaja universitare në krahasim me ato nderkombëtare?
2. A mendoni se shërbimet administrative dhe akademike plotësojnë nevojat dhe kërkesat e studentëve?
3. Cilat janë shërbimet tuaja universitare që dallojnë (jane unike) nga ato të universiteteve të tjera në vend?
4. Sa aplikohen “programet shkëmbimore të studetëve” ndërmjet universitetit tuaj me ndojnë nga universitetet nderkombëtare?
5. Përgjithësisht, sa janë të kënaqur studentët më shërbimet universitare që ju ofrohen atyre?
6. Krejt në fund si mendoni që ndikon benchmarking-u në marrjen e vendimeve menagjeriale në aktivitetet tuaja universitare?